

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e parë -I e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.01.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungon: Dardane Sogojeva Shala, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani-Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Koiqiqi - Drejtor për Infrastrukturë dhe Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 28.12.2023.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
4. Shqyrtimi i dytë i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
5. Propozim për lejimin e normave të reja në arsim.
6. Shqyrtimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Komunitet e Regjionit të Prishtinës.
7. Propozim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Miradi e Poshtme.
8. Të ndryshme: Propozimet për zëvendësime të anëtarëve në Komitetet e Kuvendit.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 28.12.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.12.2023, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, ne nuk do të votojmë për ekstraktet e procesverbaleve, për deri sa nuk respektohen dispozitat e 'Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës', po ashtu ju bëjmë thirrje edhe një herë që të rregulloni çështjen e transparencës, po ashtu kushtet në sallë nuk janë të mira për punë i nderuar kryesues, është shumë ftohtë, unë mendoj se duhet të mendojmë pak edhe për këtë pjesë, sepse jeni Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sa i përket ekstraktit të procesverbalit, unë kam një vërejtje në faqen e katërt. Fidanja është e mbjellë në rrugën 'udha e shehrit', ajo aty shërben si shenjë identifikuese në mes të rrugës, andaj duhet të largohet,

Artan Asllani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tek faqja e tetë unë e kam një vërejtje tek diskutimi im, kërkoi që të ndryshohet përmbajtja e diskutimit tim ashtu sikur e kam thënë.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit kryesues unë kam një propozim, që Sekretari i Kuvendit të ketë një asistent, sepse me të vërtetë këto lëshime nuk i bënë qëllimisht, mirëpo besoj që nuk mund të mbërrijë, sepse absolutisht nuk them se është fajtor.

Ali Ismaili: Unë e mbështes anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli në këtë pikë, megjithatë mos të harrojmë që Kuvendi i Komunës në Fushë-Kosovë i ka dy asistent me projektin e Caritas Kosova, që punojnë për Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë. Unë dua që ta japë më shumë si informacion, natyrisht se vërejtjet e juaja janë të arsyeshme që kjo sallë nuk ka kushte për punë. Unë e kam informuar Kryesuesin sot në mëngjes, se ne jemi në përgatitje për digjitalizimin e sallës dhe termat e referencës, dje ka shkuar me vendim për procedurë të prokurimit dhe do ta kemi në këtë sallë digjitalizimin e plotë, nuk do të ketë procesverbale, sepse do të bëhet publikimi i fjalëve të juaja ashtu siç thoni ju dhe do të jenë të vendosura sistemi i kamerave, mikrofonave po ua shpjegoj teknikisht ashtu siç ma kanë përshkruar ekspertët, se duhen tre monitor të mëdhenj që duhet t'i përdorim për prezantime të ndryshme.

Shpend Bardiqi: Nënkryetar ju gjatë verës nuk keni qenë këtu, mirëpo neve na është thënë që brenda vitit ka për tu rregulluar salla në katin sipër, në këtë vërejtje e kemi dhënë disa herë ndaj ekzekutivit, se nuk ka kushte për punë dhe dua të pyes, a është vendos të mos rregullohet kurrë ajo sallë atje dhe për ata po duhet të investohet këtu në këtë sallë, apo jemi duke dashur që të investojmë edhe këtu në sallën ku jemi, edhe tek salla sipër atje. Dua prapë një pyetje ta parashtroj, çka është duke ndodhur me katin sipër të Komunës?

Nënkryetari i Komunës: Komuna e Fushë-Kosovës, faktikisht kur ta ketë regjistrimin e popullsisë natyrisht se nuk do ta ketë këtë numër të Asamblesë Komunale, ku së paku edhe katër asambleistë do të shtohen, unë besoj në mënyrë të arsyeshme se do të ketë regjistrim do të krijojmë kushte dhe kjo sallë nuk do ketë vend për të gjithë. Unë i kam ftuar Shefat e Grupeve Parlamentare, e kam ftuar Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe kemi shkuar i kemi vizituar hapësirat lartë, sepse kemi menduar që do të zhvendoset salla lartë, ata që mirren me pjesën e sigurisë së vendit ku kemi menduar se do të vendosemi lartë na kanë sugjeruar, që nuk është një vend i përshtatshëm për komplet asamblenë komunale që të zhvendosen atje, duke pasur parasysh hapësirën e katit atje dhe kemi vendos që salla të mbetet këtu ku është, dje kemi angazhuar një zyrtarë arkitekt, këtu që punon në Administratën Komunale i cili do të bëjë një analizë të mureve, sepse e kemi një hapësirë të gjerë në korridor dhe nëse teknikisht ne mund të zgjerohemi pak dhe të krijojmë kushte më të mira, sepse as unë nuk po ndihem komod në atë qoshen atje. Po mendojmë që të ndërrohet edhe pjesa e inventarit, që të jetë më e ngushtë dhe të krijojë hapësirë komodi teti për të dal dhe për të hyrë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe për këtë kemi edhe buxhet. Kjo hapësirë të zgjerohet, inventari të ndryshohet dhe teknika për të cilën biseduam të vijë. E kanë bërë një pyetje teknike, sa është mobile ajo, që nëse na vijnë pajisjet më herët dhe nuk jemi zgjeruar ende, na kanë thënë se nuk e pengojnë asgjë njëra-tjetrën sepse mund të bëhet zgjerimi, sepse janë pajisje që mund të lëvizin, të instalohen janë të lehta dhe nuk do të ketë asnjë problem, për sa kohë do mundemi t'i realizojmë nuk e di,

sepse një ankesë e ndërlikon dhe e zvarrit procesin, mirëpo po shpresoj që në pranverën e vonshme së paku ju dhe pjesa e ekzekutivit, pjesa e drejtorëve që po qëndrojnë mbrapa jush do ta kenë një hapësirë më të volitshme këtu në sallë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.12.2023.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Komunës në mbledhje, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtura me datën 28.12.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju kërkoj falje të gjithë asamblistëve për seancën e fundit ku njëanshëm e mbylla pikën e rendit të ditës për pyetjet dhe përgjigjet parlamentare dhe nuk ishte në rregull nga ana ime, herëve tjera nuk do të ndodhë që njëanshëm ta mbyllim, mirëpo do të dakordohemi dhe do të vendosmi së bashku, sepse që dy vite që jam Kryesues i Kuvendit të Komunës jam munduar që të mirëkuptohemi dhe të pajtohemi me të gjithë kolegët asambleistë. Nëse e kam mirëkuptimin e juaj, do të doja të fillonim me përgjigje të drejtorëve për pyetjet e mbledhjes së kaluar, ose të fillojmë me pyetje nga asamblistët dhe përgjigjet nga drejtorët t'i merrni edhe për mbledhjen e kaluar edhe për sot. A ka mundësi ta marrim qëndrimin e Shefave të Grupeve Parlamentare?

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues ne nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pajtohemi me propozimin e juaj i nderuar Kryesues, që njëherë të parashtrijmë pyetjet asamblistët pastaj të marrim përgjigje nga Drejtorët për mbledhjen e kaluar dhe për sot.

Durim Hajra: Ne grupi i Lëvizjes Vetëvendosje dakordohemi me propozimin e juaj, vetëm a janë të gatshëm drejtorët për të dhënë përgjigje, mirëpo duke mos e përjashtuar mundësinë që t'i japim hapësirë gjithë secilit.

Mirsad Qyqalla: Pajtohemi me propozimin e juaj Kryesues, me rëndësi është të marrim përgjigje nga drejtorët dhe nuk është me rëndësi para apo pas.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po vazhdojmë me pyetje, me kusht që drejtorët në fund të na japin përgjigje edhe për mbledhjen e kaluar. Nëse nuk i marrim përgjigjet ju e dini që secili asambleistë ka të drejtë t'i parashtrij me shkrim pyetjet. Por ju lutem edhe një herë të gjithë asamblistëve, që ta respektoni kohën në foltore, e të veprojmë në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës të Fushë- Kosovës.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrijmë ndonjë pyetje nëse kanë për Ekzekutivin e Komunës.

Hasan Ismajli: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë kolegët Asambleistë, Nënkrjetar, drejtorë të drejtorive dhe KFOR-in. Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit, një objekt i cili gjendet në fshatin Pomozotin, para disa muajve kolegu im asambleistë, z. Mirsad Qyqalla e ka ngrit këtë shqetësim për një objekt tek shkolla. Drejtoria e Arsimit nuk e përdorë këtë objekt dhe aty hyjnë fëmijët dhe persona të tjerët të cilën e përdorin për gjëra jo të mira. A jeni në dijeni për këtë objekt në fshatin Pomozotin dhe kush e menaxhon, sepse sipas disa informatave që i kemi pasur na kanë thënë se atë objekt e përdor KFOR-i dhe FSK-ja, mirëpo nëse e përdorin kishte qenë mirë të marrin dhe të vendosin sigurim që mos të hynë grupe personash dhe të përdoret për gjëra tjera që janë në dëm për shoqërinë tonë.

Mirsad Qyqalla: Faleminderit Kryesues, përshëndetje Nënkrjetar dhe koleg asambleistë. Unë dua ta plotësoj asambleistin z. Hasan Ismajli, atë shkollë nuk e përdorë FSK-ja, ka qenë premtim i Nënkrjetarit të Komunës më herët i cili ka thënë, besoj që në të ardhmen ka për ta marrë. Po ashtu është shumë e vërtetë që vetëm mbetjet, për t'i parë është shqetësuese sepse sheh mbetje të përdoruesve të narkotikëve dhe është shumë shqetësuese për të gjithë banorët. Kam disa pyetje dhe po filloj me Drejtorin e Shërbimeve Publike

edhe pse Drejtori nuk qenka prezentë, mirëpo nënkryetari është këtu dhe besoj që mundet të na përgjigjet. Pyetja ime është a kemi kontratë për pastrimin e borës në Komunën e Fushë-Kosovës? Pyetjen e dytë e kam për Drejtorin e Arsimit, i nderuar Drejtor të kam parë në një televizion që ka pas ndërprerje të mësimit të fëmijëve nga ana e prindërve për mos vijim të mësimit, a mundesh të na tregosh cili ka qenë problemi, cili është shkaku që detyrohen prindërit t'i ndalin fëmijët nga shkolla. Sa i përket ndriçimit publikë çdo herë po parashtrijmë pyetje dhe asnjëherë nuk është ndërmarrë asgjë, me sa kam informacione kemi një kontratë me një kompani, mirëpo nuk e di se çka është duke u punuar në këtë drejtim. I nderuar Drejtor i Arsimit po besoj se pyetjet që i kemi parashtruar të na japësh përgjigje për gjetjet e komisionit, për rastin e çerdhes 'Gëzimi Ynë' në Fushë-Kosovë. Pyetjen tjetër e kam për Rregulloren të cilën e kemi punuar për Shërbime Publike e cila është votuar dhe i ka kaluar të gjitha, absolutisht asnjë zbatim nuk është duke u ndërmarrë në qytet. Ka qenë një Rregullore shumë voluminoze dhe i jep përgjigje shumë problemeve në qytet. Nënkryetar tek Shërbimet Publike edhe në mbledhjen e kaluar e kam potencuar, që ujësjellësi kur po punon po bënë dëm, po i dëmton rrugët, asfaltin për të cilin ne po paguajmë dhe po e kthen në gjendjen me zhavor, unë e kam printuar edhe një fotografi tek 'Udha e Shehrit' në fshatin Bardh i Madh, ka dy muaj që është kështu, shkaku i ujësjellësit dhe për atë them se kemi një Rregullore që e rregullon këtë çështje, vetëm se duhet të reagojmë dhe të flasim me ta.

Shpend Bardiqi: Përshëndetje për të gjithë, pak a shumë e sqaruar çështjen e kushteve që i kemi në sallë. Disa herë e kam ngritur çështjen e Komitetit për Komunitete që nuk jemi ekzistentë për ekzekutivin dhe Komunën e Fushë-Kosovës, saqë mbledhjet që i mbanë Komiteti për Politikë dhe Financa i mbanë me një zyre lartë ku është më ngrohtë, ndërsa dje në mbledhjen e Komitetit për Komunitete e kemi mbajtur këtu në këtë sallë të ftohtë kjo është e vërteta, sepse ne jemi shumë të parëndësishëm. Duhet të jeni më njerëzorë së paku ta kemi ngrohtë në sallë. Më herët e kam parë një listë të nën-granteve, të subvencioneve për të rinjtë, a kishte pasur mundësi fituesit që janë të jenë transparentë, sepse ne i kemi gjetur dy përfitues të shumave të mëdha, ku njëri përfitues është i Kryetarit të LDK-së nga fshati Bardh i Madh e tjetra është e afërt me Kryetarin e LDK-së në Bardh të Madh, a bën dikush tjetër diçka për rininë në Fushë-Kosovë apo veç anëtarët e nëndegëve të LDK-së, të paktën tregona emrat e përfituesve të këtyre nën-granteve. A ka mundësi dikush që nuk është i afërt me Komunën e Fushë-Kosovës të fitoj këto grante, apo vetëm kryetarët e degëve. Nënkryetar më herët kemi propozuar të kemi një kompani që harton projekte, kohëve të fundit kemi parë disa lëvizje në infrastrukturë dhe shërbime kapitale në Komunën e Fushë-Kosovës edhe ato pak investime të cilat jeni duke i bërë janë shumë të dobëta, është prishur rruga 'Mëshari' në lagjen 028 dhe 029, pak ditë pasi u shtrua u bënë gropa, nuk e besoj që i ka një muaj që është shtrua ajo rrugë me asfaltë. Unë mendoj sikurse të kishte qenë kompania që i harton projektet, edhe sallën do e zgjerohim më lehtë, po ashtu edhe katin e lartë të Komunës do ta punonim më lehtë dhe të gjitha këto punë infrastrukturore që lidhen me Komunën i kishim kryer më lehtë. Një kat i cili kryhet brenda dy jave, ju nuk e keni përfunduar për dy vite e gjysmë, ta quajmë një gjysmë kati. Prej Agjencionit për Privatësinë dhe Informacion janë dhënë disa dënime për mos qasjen e dokumenteve zyrtare, a i keni takuar, a keni ndërmarrë ndonjë masë, ndaj tyre sepse deri tash komuna është dënuar rreth 35,000.00€, për arsye se nuk po na lejoni t'i shohim dokumentet. Kjo po e sjell hetuesin tek dera e komunës, edhe prokurorinë, sepse po e fshehin një letër që është publike dhe kemi të drejtë me pa, qoftë një kontratë apo një marrëveshje, ndoshta ne pikërisht në këtë po dyshojmë diçka dhe për këtë arsye po i kërkojmë. Pse po i mbron me kaq ngulm, pse nuk po i publikoni. Pyetjen tjetër e kam për ju Drejtor i Administratës. A ka ndonjë punëtorë në Komunë, që nuk e ka takuar hetuesia?

Durim Hajra: Faleminderit Kryesues, tash nuk po e di se a t'i përsëris pyetjet e mbledhjes së kaluar, pasi nuk e di a kanë mbajtur shënime drejtorët, për atë arsye disa prej tyre po i përsërisë prapë për shkak se janë shumë të rëndësishme. Po filloj me Drejtorinë e Shërbimeve Publike për një kontratë për zhavor, pasi që vlera e tyre kalon shifrën përmbi 300,000.00€, nëse për pesë vite kalon këtë shifër, duhet së paku nëse jo për ne, të paktën për publikun të dalin dhe sqarohen, se ku ka shkuar ky zhavor. Po e parashtrij pyetjen edhe për kontratën e fundit që ka të bëjë me një kontratë kornizë për 'Furnizimin dhe Shtruarjen e rrugëve me zhavor' ku vlera është 78,790,00€, pyetja legjitime është, ku është zhavori nëse është bërë pagesa. Ndërsa sa i përket ndriçimit publik ne e përsërisim këtë pyetje në vazhdimësi, jo vetëm unë por edhe kolegët e mijë asambleistë. Unë kam vërejtur një detaj tek kontrata e fundit kornizë, për mirëmbajtjen e ndriçimit

publik, ku në atë kontratë kornizë që ka qenë për tri vite, vetëm vitin e parë është bërë pagesa afër 70% e vlerës totale të kontratës dhe unë mendoj se sado e përgjegjshme që të jetë kompania, në momentin që i paguan 70% të vlerës, mendoj që fitimin që e ka planifikuar e ka arritur dhe normal se tash është e papërgjegjshme dhe unë e shohë të pa përgjegjshëm cilin do zyrtar ose drejtorë, që e ka lejuar të paguhet mbi 70% të vlerës totale të kësaj pagese. Pse nuk ka kontratë kornizë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë stinës së dimrit sepse edhe këtë e vërejtëm në prokurim, që është kontaktuar një kompani dhe nuk e di se a janë bërë pagesat apo jo. Kam një pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës, drejtor a del në Fushë-Kosovë ndonjëherë për të parë infrastrukturën sepse po flas sinqerisht është e mjerueshme, të dalësh dhe t'i shohësh disa rrugë të Fushë-Kosovës, nëse e ke parë gjendjen si drejtor i ri, është mirë të dalësh dhe të na sqarohesh këtu. Kam parashtruar edhe një pyetje edhe për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës për disa prona, konkretisht për mbledhjen e kaluar për një pronë specifike për të cilën nuk kam marrë përgjigje, mirëpo kam pasur problem me e-mail zyrtar dhe para disa ditësh, e pash se më është kthyer përgjigje dhe unë pres të dal sot që të më japin të gjitha informatat, të cilat i kam kërkuar për atë pronë, por edhe për pronat e tjera që në opinion njihen se kanë qenë prona publike apo komunale dhe janë shfrytëzuar nga personat privat, të paktën të dimë procedurat, si janë zhvilluar që i kanë marrë ato prona. Është konkretisht në pjesën e lagjes 'Dardania', ku për vlerën e tokës në atë zonë jemi në dijeni se sa është. Po e përsëris prapë, për Drejtorin e Inspektoratit i cili nuk qenka prezent këtu. Ka disa lokale që shkaktojnë zhurma dhe probleme për banorët që jetojnë aty, e di se për disa muaj është ndërprerë veprimtaria e disa lokaleve që ushtrojnë veprimtari të jashtëligjshme aty, mendoj që edhe inspektorati duhet ta kryej punën e vetë, konkretisht për lokalet tek stadiumi i qytetit, pasi banorët kërkojnë zgjidhje afatgjate jo zgjidhje të përkohshme. Për Drejtorinë e Inspektoratit edhe një pyetje tjetër shtesë, sa ndërhyrje, sa intervenime sa gjoba janë shqiptuar për shkelësit, uzurpatorët të cilët e shfrytëzojnë pronën publike ose pronën e përbashkët dhe që vazhdojnë ta shfrytëzojnë dhe pyetja ime është, sa gjoba janë shqiptuar konkretisht për 'Parkun e Pishave në Sllatinë të Vogël' dhe pjesën e objekteve të uzurpimeve në lagjen 'Dardania' dhe gjithë qytetin e Fushë-Kosovës. Kam një pyetje po ashtu edhe për Drejtorinë e Arsimit. Drejtor a je i informuar që Kuvendi i Komunës, para tetë viteve ka marrë një vendim që është shpronësuar një pronë për ndërtimin, e një shkollë në Lagjen 'Nakarada' dhe pyetja është nëse jeni i informuar dhe pse nuk e ke prioritet të paktën të ndërtohet një shkollë e cila është planifikuar, apo të shfrytëzohet për ndonjë çerdhe publike, mirëpo gjithmonë duhet të jetë problematike çështja e pronës edhe pse e kemi një pronë, e cila është blerë me taksat e qytetarëve. Një pyetje tjetër, të gjithë jemi dëshmitar për gjendjen e dy oborreve të shkollës pas reshjeve të borës, e dimë që qyteti nuk po mirëmbahet, për shkak që nuk është një kompani e përgjegjshme, mirëpo pse oborret e shkollave nuk po mirëmbahen, që nxënësit të jenë më të sigurtë. Po i ri përsëris edhe dy pyetje që i kam parashtruar në mbledhjen e kaluar meqë qenka nënkryetari këtu. Me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, konkretisht neni pesë i rregullores thotë decedivisht auditorit duhet t'i jepet çdo qasje ne dokumentet publike në të cilat ai mendon që duhet të auditohet, e tek ne lëre që nuk ka ndodhur kjo, por Kryetari i Komunës ka iniciuar edhe masa tjera ndaj auditorit të brendshëm, duke mos i dhënë qasje dhe duke iniciuar procedura disiplinore. Unë mendoj që po shkelet ky ligj dhe kjo Rregullore. Besoj që ke një përvojë të gjatë i nderuar nënkryetar, që ke punuar si auditor në institucione publike, andaj pres një përgjigje, se përse ka ndodhë kjo dhe pyetja tjetër është, a ka Komuna e Fushë-Kosovës - Zyrtar të Pasurisë, pasi që ligji e parasheh këtë.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë kolegët asambleistë, i nderuar nënkryetar këtë pyetje kam vendosur ta parashtojë vetëm ty sepse asnjëherë nuk kam marrë përgjigje prej asnjë zyrtari të Komunës rreth shqetësimit të rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi e Epërme dhe vazhdimisht do ta parashtoj më pyetjen deri sa të ndërmerren hapat konkret për rregullimin e kësaj rruge, sepse nuk po i dimë arsyet përse nuk po investohet për rregullimin e këtij kanalizimi në këtë rrugë, pasi pyetje bëjmë çdo herë, e përgjigje nuk marrim asnjëherë. Pyetja tjetër është për shkak të shqetësimeve prej bizneseve në rrugën 'Xhemajl Mustafa' në Fushë-Kosovë, ku me vendim të Komunës janë vendosur disa kunjat në trotuare për zhbllokimin e hapësirave publike, mirëpo disa biznese janë ankuar se tek një operator biznesi 'Albi' nuk janë vendosur këta kunjat dhe këtu është bërë një dallim, duam të dimë përse nuk janë vendosur kunjat pikërisht tek ky biznes. Kam një kërkesë nga një komunitet i rëndësishëm në Komunën tonë, vendosja e sinjalizuesve të rregullimit dhe orientimit në rrugë nga personat e verbër, në veçanti dhe për personat me aftësi të kufizuar

është kërkesë edhe e tyre që Komuna të ndërmarrë veprime të cilat ju ndihmojnë për orientim dhe qarkullim nëpër rrugët e qytetit dhe të fshatrave. Kam tri pyetje edhe për Drejtorinë e Arsimit. Sa është numri i saktë i pedagogëve, psikologëve dhe asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta, sepse e dimë që Ministria e Arsimit ka dal me një buxhet për këto kategori. Shqetësimi rreth ndërrimit të orarit të klasave të pesta tek shkolla 'Mihal Grameno', Aneksi 1 në Fushë Kosovë, ku disa klasave ju është ndërruar orari e disa klasave jo. Po ashtu ka edhe ankesa që nuk po mirëmbahen aparatet për fikjen e zjarreve nëpër shkolla, është mirë që këto pajisje të shikohen dhe të rregullohen. Për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, i cili në seancën e kaluar nuk ishte prezentë, po e parashtroj një pyetje që na shqetëson të gjithëve, duam të dimë vlerën totale për renovimin e sallave të sportit, të cilat quhen të reja dhe tash kenë filluar t'i rinovoni ato. Po ashtu kam një pyetje edhe për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në lidhje me ndërtimin e mureve në QKMF-në, e cila pas një viti renovim disa mijëra euro, prapë muret janë të dëmtuara.

Artan Asllani: Përshëndetje për të gjithë ju kolegë asambleistë, kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Administratës. Në Komitetin për Komunitete i kemi pjesëmarrës dy serbë dhe po e kemi të pamundur ta zhvillojmë mbledhjen, për shkak që nuk kemi përkthyes dhe mua si kryesues po më vështirësohet mbajtja e mbledhjes, neve Hasan Gjyrevci na ka ndihmuar deri tani me përkthim, ka deklaruar se më nuk e merr këtë përgjegjësi, sepse nuk po mundet edhe të mbajë procesverbalin, edhe të përkthej, andaj kërkoj prej mbledhjes tjetër që të merret parasysh kjo kërkesë dhe të na sigurohet përkthyesi.

Habib Mekolli: Përshëndetje për të gjithë, po filloj me pyetje për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës. Një kërkesë të cilën e ka parashtuar një banorë i Komunës tonë i cili është mjek z. Hasan Krasniqi të cilin besoj që e njohim shumica prej nesh, i cili ka qenë kolegë në mandatet e kaluar, e i cili fatëkeqësisht i ka disa probleme shëndetësore të rënda dhe urgjente, i cili është detyruar që të shkoj në Gjermani dhe sipas familjarëve të këtij qytetari, atij ju është premtuar që kërkesa të vijë në mbledhje të Kuvendit dhe Komuna do t'i ndihmoj. Sipas familjarëve të tij, ai ju ka nënshtruar një operacioni dhe gjendet në mjekim intensiv, ne shpresojmë që Nënkrjetari i Komunës dhe Drejtoresha e Shëndetësisë, do ta marrin parasysh rastin dhe t'i dalin në ndihmë për aq sa është e mundur. Pyetjen tjetër e kam për Nënkrjetarin e Komunës, kronikat e zeza informative në Komunën e Fushë-Kosovës janë bërë të përditshme fatëkeqësisht, dje patëm një humbje jete në komunikacion, një plaçkitje të armatosur, herë pasë here po ankohen edhe policia, se ne jua kemi vështirësuar punën për të bërë kontrolle më të shpeshta në komunikacion, konkretisht tek çerdhja e fëmijëve në Fushë-Kosovë pasi si shkak i barrierave metalike që janë vendosur, nuk po kanë mundësi për të dalë. Ne kemi pasur deklarime publike, nga Ministria e Infrastrukturës, se Komuna e Fushë-Kosovës është pothuajse e vetmja e cila nuk ka kërkesa, kishte qenë mirë që së paku për rrugën magjistrale të bëjmë kërkesë, që së paku të ulet shpejtësia e automjeteve, sepse jemi dëshmitarë të gjithë, se ka shumë kolona të gjata e kur nuk ka kolona të gjata, ka shpejtësi të pakontrolluar.

Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë, unë kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për normat e reja të cilat i kemi si pikë e rendit të ditës sot. Pyetja ime është, a planifikohet të ketë mësues për fëmijët parashkollor në fshatin Harilaç? Po ashtu një pyetje tjetër e kam edhe për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, a planifikohet këtë vitë ndërtimi i fushës sportive në fshatin Harilaç? Projekti ka filluar para dy viteve dhe është ndërprerë. Për Nënkrjetarin e Komunës, e kam një kërkesë për të parashtuar për Ministrin e Infrastrukturës, për ndriçimin e magjistrals M9, sepse ka katër vite që ndriçimi në Fushë-Kosovë dhe Sllatinë nuk është funksional.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju falënderoj të gjithë asambleistëve për pyetjet e juaja për ekzekutivin e komunës, atëherë ftoj të na përgjigjet ekzekutivi.

Aida Alimi: Faleminderit Kryesues, Nënkrjetar, Drejtor dhe ju koleg asambleistë të pranishëm. Shumica e pyetjeve që unë kam dashur t'i parashtroje, u thanë nga kolegët. Këtu është shumë ftoftë në sallë dhe nuk ke mundësi as edhe të koncentrohesh, por pyetja ime është për qentë endacakë, ku deri tash nuk e diskutoj asnjë asambleistë, ku kemi një gjendje mjaft alarmante dhe i'u kisha lutur shumë ekzekutivit që të mirren seriozisht me këtë çështje, sepse po thonë që ne dimë të qeverisim, e të dini të qeverisni, e të mos dini t'i largoni disa qen endacak prej rrugës nuk po më duket e arsyeshme.

Nënkrjetari i Komunës: Janë disa pyetje të cilat janë në kompetencë të drejtorëve që të përgjigjen. Sa i përket objektit në fshatin Pomozotin nuk kam informacione, dua të japë përgjigje edhe për pyetjen e anëtarit

të Kuvendit të Komunës z. Mirsad Qyqalla. Po ne kemi kontrate për pastrimin e borës në Komunën e Fushë-Kosovës. Pyetjen tjetër e parashtruan për pagesat ku besoj që do të na lajmërohet për përgjigje dikush nga Drejtoria përkatëse dhe të na tregoj, se a ka pasur pagesa pasi që unë nuk e di. Sa i përket problemit të orarit në shkollë, ne kemi pasur një ndryshim të orarit në shkollën 'Mihal Grameno' për klasat e katërta dhe të pesta, ku kemi pasur reagime të prindërve. Ju e dini se është një orar që vendoset në nivel të shkollës, kemi kuptuar që ndryshimi ka qenë nga Këshilli i Shkollës, përfaqësuesit e prindërve dhe të gjithë kanë votuar për. Për kundër kësaj kishim një shqetësim i cili ishte i pa arsyeshëm për ndryshimin e orarit mësimorë gjatë vitit shkollor, nëse nuk ka nevoja të veçanta. Unë së bashku me Drejtorin e Arsimit i kemi kërkuar Drejtorit të shkollës për një takim së bashku me Këshillin e Shkollës, që të takohemi edhe një herë dhe janë takuar ditën e premte dhe e kanë sjellë të njëjtin vendim për ndryshim të orarit. Unë personalisht kam takuar tri herë grupin e prindërve të pakënaqur, ditën e hënë jemi takuar me prindërit dhe ju kemi treguar se tash është një çështje që duhet të ngritet në instanca të tjera, në mënyrë që të mos keqpërdoret autoriteti i menaxhmentit të komunës për ndërhyrje në ndryshimin e orarit të mësimit. Ne i kemi bërë një shkresë Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe kemi kërkuar, që ta rishikoj komplet procesin e marrjes së vendimeve, edhe nga kuptimi ligjor, edhe nga kuptimi përmbajtësorë dhe t'i rekomandojë komunës apo shkollës një vendim dhe ne do ta respektojmë, vendimin e Inspektoratit të Arsimit. Kërkesa ime ndaj prindërve ka qenë që fëmijët të vazhdojnë mësimin, shumica e klasave vetëm se janë kthyer dhe kanë filluar mësimin. Pyetja tjetër ishte për 'Kontratën e ndriçimit publikë', nuk kemi sepse i ka thyer procedurat dhe është në fazën e ankesave në prokurim dhe presim pasi të kryhet kjo faza e ankesës të kemi kontratën për ndriçimin, ndërsa sa i përket pagesës së 70% besoj se dikush do të dalë dhe të na japë përgjigje për këtë. Rruga e Shehrit, ishte ujësjellësi dhe po Mirsad, ata duhet ta kthejnë në gjendjen ekzistuese, por nganjëherë ne po kemi shumë nevojë për ujësjellësin dhe institucionet e tjera dhe po është e vështirë për ne që të përdorim mekanizmin e inspektorëve dhe të shqiptojmë gjoba dhe dënime për institucionet publike sepse jemi në nivel të bashkëpunimit. Mirëpo pajtohem se dëmet të cilat bëhen duhet të riparohen ose nga ujësjellësi ose ne si komunë, nëse dëshirojmë me pas një relacion të shëndoshë me kompani publike. Komiteti për Komunitete u cek se nuk ka kushte, unë e kisha lutur Kryetarin e Komitetit që sa herë të keni Mbledhje të Komitetit, zyrën time do ta keni në dispozicion, ejani dhe punoni si komunitet deri sa të bëhet kati, ndërsa sa i përket punës së përkthyesit besoj se do ta keni një përgjigje nga Drejtori i Administratës. Lista e subvencione për përfituesit e grupit të rinjve, sot gjatë ditës i nderuar Shpend do të mundohem që ta siguroj listën e përfituesve, sepse është grantë nga MAPL-ja në bashkëfinancim me Komunën. Ka qenë një shpallje publike dhe herën e parë nuk ka ardhur asnjë organizatë rinore e Komunës së Fushë-Kosovës për të aplikuar. E kemi përsëritur edhe herën e dytë kanë ardhur ata që kanë ardhur, vlerësimi i atyre është bërë me një Komision tre palësh nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, donatori Banka Botërore dhe një përfaqësues i Komunës. Nëse ju duhet qasje në Komisionin e Vlerësimit mund ta kërkonte tek MAPL-ja sepse komplet procesi është zhvilluar atje, sepse kanë përfituar edhe shumë Komuna tjera, ndërsa listën për Komunën e Fushë-Kosovës e kam unë. Po ashtu ishte një pyetje për rrugën 'Mëshari' dhe unë nuk po dua që t'i përsërisë ato. Një herë në muajt e kemi këtë mbledhje dhe ky është një projekt i përbashkët me Ministrin dhe Komunën po ashtu ka një komision të përbashkët për punë që u bë aty dhe një përfaqësues nga komuna. Unë kam kaluar javën e kaluar në atë rrugë dhe e kam parë që ka fillua me u dëmtua, e kam ngritë si çështje dhe më kanë thënë që projekti është i papërfunduar dhe besoj se do ja japim kohën e mjaftueshme Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, po ashtu edhe përfaqësuesit tonë për me përfundua projektin sepse ende nuk ka përfundua. Menaxherët e kontratës janë nga Komuna dhe Ministria. Për Agjensionin për Privatësi dhe Informacion nuk kam shumë se çka me thënë sepse komuna duhet me i pagua dënimet dhe komuna e ka obligim me bë një raport vjetor, për këtë pjesë në bazë të ligjit dhe komuna duhet me shkrua këtë raport vjetor dhe besoj, që komuna duhet me bë një raport të qasshëm për me pas qasje në dokumentet publike, sepse është obligim ligjor. Një pyetje ishte për Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, mirëpo po përgjigjem unë sa persona janë në hetuesi pyetja ishte nga Shpendi? Shpend besoj se kjo është puna ime e fundit dhe Drejtorit të Administratës, mos të përzihemi t'ua lëmë hetuesisë ta kryejnë punën e vetë, sepse ne nuk e dimë kush ku shkon dhe në çfarë cilësie shkon dhe komuna nuk mban evidencë, se kon po e thirr hetuesia dhe të pajtohemi, që ta lëmë në kompetenca të tyre. Po janë bërë pagesat për kompaninë e borës, jam në dijeni për punën që ka auditori në relacion me Kryetarin e Komunës

dhe me pjesën e menaxhmentit dhe nuk do japë një konstatim të kësaj çështje, mirëpo auditori i brendshëm është këshilltar i Zyrtarit Kryesor Administrativ cilit do nivel qoftë ai sipas ligjit. Tri auditime që janë tu bërë të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Komunën e Fushë-Kosovës, kanë qasje të plotë në të gjithë dokumentacionin që ekziston, mirëpo është një relacion që duhet të shikohet sa i përket auditorit të brendshëm. Ne kemi sinjalizues dhe Agjensioni Antikorrupsion i ka emrat e sinjalizuesve të Komunës së Fushë-Kosovës, unë nuk kam parë që sinjalizuesi jonë, ka pas një problem me dhënë një informacion. Sa i përket zyrtarit të pasurisë nuk e di se a ka, mirëpo e di se ka komision të pasurisë dhe e ka bërë një raport për pasurin e komunës dhe e di, se në bazë të ligjit procedura duhet me u vazhdua me një komision tjetër në bazë të raportit të parë, që është komisioni për zhvlerësimin e pasurisë, ky komision i dytë është bërë dhe ky komision për momentin është duke e zhvilluar aktivitetin e tij dhe nëse do të kemi rezultat që ky komision do të thotë, që për një pasuri për blerjen e vetë duhet të kaloj te komisioni i tretë, atëherë kjo pasuri do të kalojë për tjetërsim nëse ka nevojë, por me kuptimin ligjor dhe afatet ligjore. Nuk e di se ne a kemi apo s'kemi zyrtar të pasurisë. Dua t'i përgjigjem Vlonjatit unë nuk shohë arsye që ne duhet me diskriminuar një rrugë, unë do ta shohë edhe tek buxheti i këtij vitit, meqë nuk shohë arsye për diskriminimin e një lagjeje apo një rruge, do të interesohem së bashku me drejtorinë, sepse ju e dini se këtë vitë është hera e parë që është bërë planifikimi i buxhetit me emrat e rrugëve konkrete, të cilat do të financohen. Unë kam qenë insistues që të jenë edhe emrat e rrugëve dhe ta shohim, se ku do të bëhen investimet. Patëm edhe një pyetje nga asambleisti Habibi rreth çështjes së z. Hasan Krasniqit, unë e kam takuar atë personalisht dhe ka pasë një kërkesë që ne t'i ndihmojmë financiarisht, e kemi menduar që ta fusim si pikë të rendit të ditës për këtë mbledhje, mirëpo i kemi tri raste po thuajse të ngjashme të qytetarëve tjerë të Komunës së Fushë-Kosovës dhe ka qenë e vështirë për ne me nda lëndën e tij, me sjell në Kuvend dhe mi lënë rastet e tjera që kanë po thuajse të njëjtën diagnozë, në mëngjes kam biseduar edhe me Kryesuesin. Pa dashtë të bëjmë dallime Hasan Krasniqi është punëtorë i kësaj komune dhe është dashur të ketë një përparësi për trajtimin, sepse secili institucion e ka për obligim me u kujdes për stafin e vetë dhe mendoj se kjo nuk është diskriminuese, nëse komuna i ndihmon punëtorit të vetë, mirëpo ne e diskutuam dhe vendosem që të shikojmë, se a mundemi t'i sjellim tri rastet në mbledhjen e radhës. Tani z. Hasan Krasniqi e kemi ndihmua edhe një herë me vendim të Kuvendit, mirëpo sëmundja e tij është vështirësuar, ku unë kam takuar edhe familjarët dhe miqtë e tij dhe jam interesuar për shëndetin e tij. Po më vjen shumë mirë nga ana juaj, sepse keni disponim për me i ndihmuar. Kërkesat tona në Ministrinë e Infrastrukturës për financimin e projekteve, ne i kemi kërkuar dhe shkresa e fundit ka shkuar nga ana ime, e cila është e protokolluar dhe e dorëzuar, ku kemi kërkuar një projekt me na ndihmua në rrugën magjistrale Sllatinë e Madhe/Graboc i Poshtëm dhe rrugën që hynë te tregu këtu hyrja për në Uglar dhe del te 'Bau Marketi', e cila është shumë e dëmtuar dhe kemi kërkuar nga Ministria e Transportit, me na ndihmuar edhe rrugën rreth Hekurudhës, pastaj deri tek 'Maja e Goleshit', sepse është një pjesë e bizneseve që zhvillohet andej dhe kërkesa tjetër te 'Rrafshina/Harilaç, ku kemi një numër të madh të nxënësve që frekuentojnë atë linjë. Kemi kërkuar që cilat prej këtyre projekteve mundet ministria me na ndihmuar dhe ne jemi të gatshëm për bashkëfinancim. Janë kërkesa të adresuara nga ana ime. Sa i përket ndriçimit publikë kemi së paku katër kërkesa që ju kemi drejtuar Ministrisë. Fatëkeqësisht s'po mundemi me gjetë mirëkuptim për rrugën 'Nëna Terezë' dhe ta kemi një qasje më të lehtë, mirëpo fatëkeqësisht përgjigjja është negative.

Hasan Ismaili: Unë z. Hasan Krasniqi, e kam pasur bashkëpartiakë dhe bisedoj çdo mbrëmje me të, Hasani e ka pasur gjendjen urgjente me shkua dhe mu operua, ku diagnoza e tij është shumë e rëndë, ku ka kancer në mëlçi. Ka shkuar është operuar dhe shpresojmë që ta kalon sa ma shpejtë këtë sëmundje. Ne e dimë se ka edhe raste të tjera me këtë sëmundje vdekjeprurëse dhe të gjithë kanë nevojë me kërkuar ndihmë. Hasani është laborant dhe me vite të tëra ju ka shërbyer qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës dhe nuk shohë arsye pse mos me i ndihmuar. Ne jemi të gatshëm dhe do ta votojmë dhe do ta ndihmojmë kurdo që ekzekutivi na përkrahë dhe e bëjnë si pikë të rendit të ditës, qoftë edhe mbledhjen e jashtëzakonshme, shihe mundësinë Nënkrjetar i Komunës dhe t'i ndihmojmë.

Ardit Sekiraqa: Ne kemi dal me dhënë përgjigje për pyetjen e Durimit, ku së pari kam një vërejtje që të mos vini në kolaudime kaq shpejtë pa pasur informacione shtesë, ne jemi të hapur për të gjithë që të vini të merrni informacione qoftë tek ne apo drejtori pastaj ta bëni mediale. Në kontratën e zhavorit jemi tre menaxhera ku kjo kontratë ka të bëjë me furnizim dhe rregullim të rrugëve, nuk është veq furnizim, ne e

kemi edhe një raport i cili ka shkuar tek certifikuesi dhe ju kisha lut hera tjera ta kompletoni lëndën, sepse kur ta dërgojmë një situacion për pagesë e dërgojmë edhe raportin, ku raporti përmban gjatësinë e rrugëve dhe gjerësinë e rrugëve me emrin e rrugëve, ku ka shkuar zhavorri në këtë raste, ne i kemi edhe fotot nëse keni interesim mundeni me ardhur dhe me i parë, ne kur ta përfundojmë një kontratë së pari e përgatisim dokumentacionin dhe vijmë e kontrollojmë auditori i jashtëm dhe i brendshëm, kjo dallon prej kontratave tjera ku në këtë kontratë ka pozicione te ndryshme, gërmimi, nivelizimi i nën-bazës, furnizimi dhe shtruarja e zhavorrit dhe ngjeshja e zhavorrit. Për me ardhur deri tek kjo kontratë ne jemi marrë si projektues dhe si zyrtar, për arsye se më herët kemi pasë ankesa nga qytetarët që zhavorri s'ka qenë i shfrytëzueshëm. Kemi ardhur në përfundim që ne me bërë një paramasë, që kur të shtrohet zhavorri me qenë i shfrytëzueshëm dhe rruga me qenë e kalueshme dhe kur të vie te shtrimi i asfaltit ta bëjmë një trajtim të vogël dhe ta shtrojmë asfaltin. Për ta shtruar një rrugë më zhavorr duhet që së pari ta kemi kërkesën nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ku kjo kërkesë shikohet, dalim në teren i shikojmë dhe i zgjedhim. Çka do që keni rreth kësaj kontrate ne do ju japim përgjigje.

Durim Hajra: Ne sa kemi informacion japim edhe opinion, konkludim s'kemi dhënë për këtë çështje, ne kemi dhënë opinion në bazën e asaj se si është planifikuar dhe si është shpenzuar. Mbi bazën e kësaj që kemi parë është një shumë e madhe e cila është shpenzuar për zhavorr, sepse ne jetojmë këtu dhe të gjithë e dimë, se sa mundet me kushtuar një rrugë nëse shtrohet me zhavorr. Për ne çështja e zhavorrit është dyshuese, sa i përket kontratës së fundit, unë e kam kryer punën time si asambleistë, e kam shprehë shqetësimin tim si asambleistë edhe përmes mediave, se ne në këtë kontratë dyshojmë se ka keqpërdorime në bazë të asaj që është publiku. Për taksat e qytetarëve është edhe raporti që duhet të jetë i publikuar. Dyshimin tonë mendoj se nuk duhet me marrë aq personale, e nëse ka diçka atëherë është diçka tjetër. Ne dyshojmë jo vetëm për zhavorrin por edhe për shumë projekte të tjera që po keqpërdoren.

Ardit Sekiraja: Ndoshta unë nuk është dashur me dalë në foltore, po e sheh se jam për herë të parë dhe ndoshta nuk jam i artikuluar mirë. Arsyeja pse kam dalë është se ne po kemi presion si zyrtar publik, po duhet mu ballafaqua me shumë gjëra të tjera për të qenë transparentë, neve nuk na ka kërkuar askush përgjigje për pyetjen e juaj dhe për ata po them, nëse keni dyshime kërkon emrat te cilët janë në raport dhe ejani dhe kërkon informacione dhe të dhëna për çështjen e caktuar. Ne i kemi mbi 100 kërkesa të cilat janë shumë urgjente për zhavorr, shtrohet pyetja pse është urgjente zhavorri, pse është kjo kontratë. Ka raste nga më të ndryshmet, e kemi një rast në Nakaradë, ku kemi një qytetarë me dializë dhe ambulanca nuk mundet me hy deri tek shtëpia e tij, ndalet 40 metër larg shtëpisë ambulanta dhe për këto 40 metër rrugë, ai duhet me pritë deri në muajin gusht dhe kjo kërkesë ka qenë shumë urgjente, ne e kemi shtruar me këtë kontratë dhe këtu ne nuk kemi pasur prioritet për vete, por ka ardhur prindi na ka lutur që t'i bëjmë zgjidhje se po duhet me marrë fëmion dhe me dërguar tek ambulanta, kjo është në rrugën 'Fehmi Lladrovci', këtë mundem me dëshmuar.

Drejtori për Infrastrukturë: Përshëndetje për të gjithë, ju dëshiroj një vitë të mbarë. Rruga 'Mëshari' është një rrugë e cila tregoj edhe Nënkryetari i Komunës së Fushë-Kosovës dhe kjo rrugë ka shkuar në prokurori, të cilën e ka dërguar kolegu im Shyqeri Krasniqi. Këtë vitë kemi paraparë rreth 400,000.00€ asfaltime në Fushë-Kosovë, rruga 'Hajrullah Zymi' 240,000.00€, rruga 'Hamdi Grajçevci' 60,000.00€, rruga 'Enver Maloku' 100,000.00€, po ashtu janë paraparë për këtë vitë riparim të rrugëve afër 207,000.00€. Shtyllat anti parking tek 'Albi' këtë projekt e kam filluar unë dhe e ka përfunduar Drejtori i Shërbimeve Publike. Unë u mundova me kontaktuar me mbikqyrësin e këtij projekti, por nuk u përgjigj në telefon, sepse koha e pauzës dhe pas pauzës, unë do ta kontaktoj dhe do ju informoj.

Mirsad Qyqalla: Këtë pyetje që e parashtror kolegu im Vlonjati, unë e kam parashtruar muajin e kaluar dhe që një muaj nuk keni mundur me na dhënë përgjigje.

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kur e kemi renovuar gjimnazin 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë, njëherë kemi menduar t'i rregullojmë tauletet, pastaj e kemi vlerësuar se aty duhet të rregullohet komplet kati, kjo punë tani është kryer aty, e kemi marrë edhe një donacion nga një qytetarë për një ashensorë dhe një tauleti të veçantë. Lidhur me raportin e 'Çerdhes së Fëmijëve 'Gëzimi Ynë', me marrjen e informatës së punëtorët janë në paraburgim, kemi kërkuar nga Komisioni Disiplinor

shqyrtimin e këtij rasti, dy punëtorët janë ndëshkuar me masën disiplinore, të ndalimit të pagës së tyre 20% për periudhën tremujore, ndërsa ndaj Drejtoreshës së çerdhes e kemi filluar procedurën disiplinore, me arsyetimin se videot dhe incizimet e kamerave, mund të mirren vetëm nga Policia me kërkesën zyrtare të Prokurorisë së Shtetit, është vendosur që asaj t'i ndalet 30% e pagës për periudhën tre mujore. Lidhur me kërcnimet e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Vlonjat Hasani, se lëndën për rregullimin e rrethojave në oborret e shkollave të fshatrave: Miradi e Epërme dhe Graboc i Poshtëm, do ta dërgoi në krime ekonomike, ne tani jemi në fazën përfundimtare të këtij projekti, aty Komisioni për pranimin teknik, do ta vlerëson projektin sipas paramasës së tij, është e padrejtë të keqë përdoret në këtë mënyrë, realizimi i një projekti publik, pa pranimin e tij, meqë puna aty nuk ka përfunduar ende. Lidhur me objektin shkollorë në fshatin Pomozotin, ai objekt duhet të përshtatet dhe do të përdoret për arkivë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Problemi qëndron në faktin se ai objekt tani po përdoret për dukuri negative nga persona të caktuar, për këtë punë këtu në komunë ka ardhur përfaqësuesi i fshatit Pomozotin z. Ajet Kodra dhe ka kërkuar që të bëni një zgjidhje, andaj unë kërkoj që të bëni diçka në këtë drejtim.

Drejtori për Arsim: Lidhur me pronën në Nakaradë, unë do të konsultohem me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Drejtorinë e Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, shkollat tona gjatë dimrit janë mirëmbajtur, secilës shkollë ua kemi dërguar thasët me kripë dhe mjetet e punës. Do ta trajtojmë edhe sigurimin në shkolla, por ne po kemi probleme me norma për mësues, secila shkollë i kanë edhe aparatet për zjarre fikje.

Vlonjat Hasani: Ne nuk pajtohemi me këto përgjigje të përgjithësuara, pa argumentim të veprimeve që duhet të mirren nga organet përgjegjëse, pas situatës së ndodhur në çerdhe unë kam dëgjuar se prindi e ka tërhequr edhe vajzën e tij nga kjo çerdhe publike. Po jepen shuma të mjeteve monetare për dënime, meqë nuk po lejohet qasja e komunës në dokumente publike.

Migjen Kolshi: Kërkesa ime e vazhdueshme është që edhe fshati Harilaç, të ketë mësimin parashkollorë, kam informata se fshati unë është ndëshkuar nga Kryetari i Komunës, pas dështimit të Kuvendit zgjedhor të partisë në pushtet në fshatin tonë, më vonë edhe vetë jam bindur se kjo punë është e vërtetë, por është e pa arsyeshme, unë kërkoj nga ju që kjo kërkesë të plotësohet gjatë këtij viti.

Drejtori për Inspektorat: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam pasur disa pyetje edhe në mbledhjen e muajit dhjetor, ju njoftoi se atëherë kam qenë në pushim, ne tani jemi duke i marrë disa aksione në teren, për zbatimin e Rregullores për Shërbime Publike, që kanë të bëjnë me vendosjen e reklamave pa pëlqime, ndërhyrjet në rrjetet e kanalizimeve, kemi pasur edhe një aksion të përbashkëta me Policinë e Kosovës në nëntë pika, por për arsye konfidenciale nuk mund të jap informata më shumë, por kemi të bëjmë me dukuri negative dhe të jashtëligjshme, si rezultat i këtij aksioni dy lokale janë mbyllur. Kemi dhënë disa gjopa për ndërtime në zonën e pishave, por atje ndërtimet janë në prona private, por aty shfrytëzohet hapësira publike e zonës pyjore, disa hapësira janë liruar, ka hapësira të caktuar në metra katror që janë të lejuara të shfrytëzohen me pëlqime dhe në këto raste nuk ka gjopa për shfrytëzuesit.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë sot i mora këtu tri pyetje nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, përgjigjet unë do t'i jap me shkrim për pyetjet e parashtruara.

Drejtori për Administratë: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ne nga Agjensia për Privatësi dhe Informacion, i kemi marrë disa gjopa dhe unë apeloj se këto duhet të paguhen, unë këtë punë e kam marrë nga muaji i gjashtë i vitit 2023, nga atëherë i kam pranuar tridhjetë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, media dhe shoqëria civile, komuna është përgjigjur në shumë raste, ka raste kur nuk jemi kompetentë për përgjigje dhe i zbatojmë dispozitat ligjore. Lidhur me përkthyesin do ta shohim vëllimin e punës dhe do ta gjejmë një zgjidhje.

Mirsad Qyqalla: U tha se e kemi një kompani për pastrimin e borës, por në teren bora nuk është pastruar, u tha nga Drejtori i Infrastrukturës këtu se unë nuk kam qenë në mbledhjen e muajit dhjetor, kjo nuk qëndron, sepse unë duke e parë prezencën e tij në sallë, e kam parashtruar pyetjen time, ne këtu pyetjet i paraqesim për të zgjidhur problemet që na vijnë neve nga qytetarët, nuk i kemi personale. Lidhur me shkollën e vjetër në fshatin Pomozotin, të gjithë e dijim se kjo shkollë po përdoret nga persona për dukuri negative, andaj së paku duhet të rrethohet nga komuna.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e tretë (3) - Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, është përgatitur nga z. Hasan Gjyrevci, jemi pajtuar që ta bëjmë një raport më ndryshe prej herave të tjera, me shumë sqarime për procesin e vendim marrjes, vlerësimin e vendimeve, zbatueshmërinë e tyre, lidhur me transparencën ne i kemi adresuar shkresat zyrtare në drejtim të Ekzekutivit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Unë mendoj se ky raport është përmbajtësore, do ta publikojmë në ueb-faqën e komunës, shërben për statistika dhe për opinion publike, sepse e pasqyron punën reale në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Tani këtu esenca e përmbajtjes së raportit të punës së Kuvendit të Komunës, u tha qartë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, unë ju përgëzoi për punën e kryer në strukturimin e këtij raporti në formën tabelare me zberthim të detajizuar. Kuvendi i Komunës në vitin 2023, ka miratuar katër rregullore komunale dhe gjashtë plane të veprimit, të cilat i rregullojnë shumë fusha me rëndësi në kuadër të kompetencave të komunës, shumica e vendimeve tona janë të ligjshme dhe të zbatueshme. Një problem i madh në realizimin e buxhetit të komunës, ka qenë vonesa në zhbllokimin e të hyrave vetanake të komunës, vetëm në muajin gusht të vitit 2023.

Durim Hajra: Ky raport i punës së Kuvendit më shumë është informues, problemi qëndron se me votat e shumicës kanë mbetur në fuqi disa vendime të vlerësuara si të kundërligjshme, për të cilat ne si opozitë ua kemi tërhequr vërejtjen në fazën e shqyrtimit të tyre, me qëllim të harmonizimit të tyre me ligjin. Sfidë në vetë-vetë, që nuk është zgjidhur është krijimi i kushteve për punë të rregullt në Kuvend dhe mungesën e publikimit të audio-incizimeve të mbledhjeve tona për opinionin publikë.

Vlonjat Hasani: Unë mendoj se është e arsyeshme që në raport të evidentohen sfidat për funksionimin më të rregullt të Kuvendit, sepse kemi pasur raste kur rekomandimet, që nuk kanë kaluar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por janë shqyrtuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe janë marrë vendime.

Pika e katërt (4) - Shqyrtimi i dytë i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne tani e kemi në shqyrtimin e dytë 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2024', gjatë punës së Grupit Punues, ne i kemi mbajtur dy takime, janë marrë parasysh propozimet e subjekteve politike, me përjashtim të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila vetë ka vendosur të mos marrë pjesë në punën e Grupit Punues, ku plan është një orientim për punën tonë një vjeçare.

Laureat Gojnovci: Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, është racional dhe me përmbajtje të propozimeve që parashihen me ligjet në fuqi, ku hyn edhe Korniza Afatmesme Buxhetore, Plani Zhvillimor Komunal, për pyetje kemi pasur diskutime për respektimin e kohës nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, për të mos elaboruar shumë pyetjet pa nevojë. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës', të përgatitur nga Grupi Punues i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovuan 'Projekt-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e normave të reja në arsim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për norma të reja në arsim', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kam sqaruar se këto mjete financiare nevojiten për pagesën e mësimdhënësve zëvendësues, vetëm katër vende janë norma të reja në arsim, procedurat për këtë të punësuar janë zhvilluar. Në shfmu janë dy mësimdhënës, në shml një mësimdhënës dhe një asistentë për persona me nevoja të veçanta. Mësimdhënëset që shkojnë në pushimin e lehonisë gjatë një viti shkollorë, mbesin në listën e pagave në secilin institucion shkollorë, ne në këtë rast i kemi njëzet e një zëvendësime në shfmu, tetë zëvendësime në shml dhe një sekretare. Një pushim i lehonisë mbulohet për periudhën gjashtëmujore, nëntëmujore dhe tre muajt e fundit pa pagesë, pra një vitë mbetet në listën e pagave si numër dhe nuk mund të shtohet numri i punëtorëve, pushimet e lehonisë duhet të zgjidhen në nivel vendi, sepse këto probleme i kanë edhe komunat tjera të vendit, por deri sa nuk ofrohet kjo zgjidhje, ne mësuesin për nxënës duhet të kemi në shkollë, rekrutimet për këtë mësues zëvendësues janë kryer.

Fisnik Sllamniku: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim ofrimin e kësaj zgjidhje për mësuesit zëvendësues, por kërkojmë njëkohësisht që Drejtoria e Arsimit të merret me problemet tjera në arsim, ku hyn edhe mësimdhënësit e sëmurë, të cilët zëvendësohen ndonjëherë edhe nga kolegët e tyre, ne po e përdorim si një lloj xhokeri personelin arsimorë që e kemi, nxënësit nuk duhen të humbin orët e mësimin, por komuna duhet të gjen zgjidhje të përkohshme, por mundësitë për të gjetur zgjidhje afatgjata janë të kufizuara. Mësimdhënësit që e mbajnë mësimin në fund të muajit duhet të paguhet për punën e tyre, e jo të jenë të obliguar që pagat e tyre t'i realizojnë në procedurë gjyqësore e përmbarimore, me kosto më të lartë financiare për komunën.

Durim Hajra: Në punën e mësimdhënësve zëvendësues e diskutuam dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne i kuptojmë problemet e arsimit në komunën tonë, por për këtë ka përgjegjësi edhe niveli komunal, neve nuk na kanë ardhur shkresat zyrtare të komunikimit të komunës me Ministrinë e Arsimit për zgjidhjen e këtyre çështjeve për realizimin e pagesave të mësuesve tonë, vetë Drejtoria e Arsimit ka personel të mjaftueshëm për përgatitjen e një propozim-vendimi të argumentuar, e jo një propozimi sikur na është dorëzuar neve për shqyrtim dhe vendim në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës. Ne nuk e kemi materialin e dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit, nuk e kemi të specifikuar as burimin e mjeteve financiare, prej të cilit do të realizohen këto pagesa. Dua të përsëris këtu prapë se këtu kërkohe pagesa për periudhën njëvjeçare, ne e dijm se Ministria e Financave nuk e pranon një vendim të tillë, madje ne e kemi një sqarim edhe lidhur me vendimin e marrë për pagesën e njëzet e katër mësuesve në muajin gusht të vitit 2023, andaj për Grupin Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, kjo formë e trajtimit të propozimeve është e papranueshme, neve po na shtyeni të mos marrim pjesë në votim, duhet ta kundërshtojmë këtë propozim, sepse është i mangët në aspektin formal dhe përmbytësorë.

Hasan Ismajli: Tani nga shpjegimi e kuptuam se tridhjetë norma, nuk janë punësime të reja, por janë zëvendësime të mësuesve dhe vetëm katër janë punësime të reja. Unë hulumtova dhe e kuptova drejtë se probleme të tilla kanë një numër i komunave, ndër to edhe Komuna e Podujevës, e cila i kishte pesëdhjetë e tetë mësues në zëvendësime, unë jam idhëtarë që në parim propozimet për përkrahjen e mësuesve dhe punëtorëve shëndetësorë, t'i përkrahim, sepse fëmijët duhet të kenë mësuesin në klasë, unë e kuptoi se ky edhe mund të jetë një vendim i kundërligjshëm, por mësuesit e rekrutuar nga Drejtoria e Arsimit janë duke punuar, ata duhet të paguhet për punën e tyre, andaj unë parimisht e përkrah këtë propozim, nuk më intereson si e sheh zgjidhjen komuna për këtë rast, unë e përkrah secilën mënyrë të pagesës nga buxheti i komunës për mësues.

Nënkryetari i Komunës: Tani këtu nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit u sqarua, se kostoja financiare e mbulimit të pagave të këtyre mësimdhënësve për një vitë është në shumën e mjeteve financiare prej: 266,000.00€, këtë pagesë ne duhet ta bëjmë nga të hyrat tona vetanake, sepse në kushte normale pagesa e

mësuesve zëvendësues do të duhet të bëhet nga granti qeveritarë. Me Ministrinë e Arsimit ne jemi në komunikim për shqyrtimin e mundësisë për gjetjen e një zgjidhje, takimin e paraparë unë e kam shty për nesër në orën dhjetë, ne mendojmë që këto pagesa të bëhen nga kategoria ekonomike e mallrave e shërbimeve apo subvencioneve, ne në këtë kuptim do ta kemi një keqë klasifikim lidhur me opinion e auditimit, por nxënësit në klasë nuk kemi të drejtë t'i kemi pa mësues, kjo nevojë në parim duhet të përkrahet, në kuptimin e rendit të gjërave, ne duhet ta marrim një vendim sot dhe pagesën ta bëjmë nga buxheti i komunës, jashtë kategorisë ekonomike të pagave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne nuk mund të marrim vendim në parim, por vendimi i Kuvendit të Komunës, duhet të jetë i specifikuar me burimin e financimit.

Durim Hajra: Unë e kuptova Nënkrjetarin e Komunës i cili na bënë thirrje për ta votuar një propozim të tillë, na nuk e kemi informatën për komunikimin me Ministrinë e linjës, ju jeni në qeverisje dhe kërkoni rezultate të shpejta, ne e dijm edhe opinionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, por një propozim-vendim duhet të jetë i qartë, nëse ne në vendimin tonë themi se pagesa do të bëhet nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, e kemi vlerësimin e Ministrisë së Financave, me sugjerimin që pagesa mund të realizohet vetëm nga kategoria ekonomike e subvencioneve. Pse kjo kërkesë nuk është bërë në muajin qershor, kur ka filluar përgatitja e buxhetit për vitin 2024.

Nënkrjetari i Komunës: Ne këtu po e qartësojmë, se kjo është nevojë momentale, në shtator do të kemi nevojë edhe për shumë mësues, sepse pritet ta hapim shkollën e re. Unë pajtohem se në Kuvend duhet të shqyrtohen propozim-vendimet e qarta. Nuk them as që Ministria e Arsimit i ka fajet, sepse na kanë dhënë norma të reja në arsim me buxhetin e vitit të kaluar, por shtimi i nxënësve nga migrimi i brendshëm në komunën tonë është i lartë.

Hasan Ismajli: Shih kjo punë nuk është një temë e thjeshtë. Për këto pushime të lehonisë, janë hap konkurset për zëvendësime, këto procedura ne i kemi të qarta, unë mund të jem kundër politikisht, por propozimin për pagesat e mësuesve që e mbajnë mësimin e votoi për.

Vlonjat Hasani: Qëndrimin e Grupit tonë parlamentarë e tha kolegu z. Durim Hajra, ne këtu materialin e Drejtorisë së Arsimit e kemi jo komplet, nuk e kemi komunikimin zyrtar me Ministrinë e Arsimit, edhe Nënkrjetari i Komunës i dha vërejtjet për propozimin në fjalë, këtu po synohet të nënkuptohet se këtu Lëvizja Vetëvendosje është kundër arsimit dhe mësimdhënësve, ne parimisht e përkrahim propozimin në fjalë, por ky propozim-vendim duhet të rregullohet si duhet.

Fisnik Sllamniku: Normat për mësues janë të rëndësishme, ne jemi shumë larg kriterit rregullativ e ligjor, sepse i kemi 45 nxënës në një klasë, andaj kemi nevojë për shumë mësimdhënës. Ne duhet të punojmë për zgjidhje praktike tani, unë dua ta marrë një shembull me mbikalimin në rrugën magjistrale M9, ku në fshatin Vragoli e kemi mbikalimin, ndërsa në fshatin Miradi e Poshtme, nuk është lejuar, është bërë një zgjidhje alternative nën urë për banorët, edhe në fushën e arsimit, duhet të gjejmë një zgjidhje të kohës, të përkohshme, sepse zgjidhje nga niveli qendror tani nuk ka për këtë punë, në nivel vendi, andaj ne e përkrahim një zgjidhje sipas kalkulimit që e kemi bashkangjitur me propozimin në fjalë, për pagesën e tridhjetë e katër mësues për periudhën një vjeçare.

Drejtori për Arsim: Zgjidhja të bëhet nga ekspertët në nivel vendi, po ne e kuptojmë situatën se kemi probleme të theksuara në arsim, me çështjen e pagesave, ne tani nga 964 punëtorë në nivel komunal, 707 i kemi në arsim, e kemi një pedagog për njëmbëdhjetë mijë nxënës, duhet t'i kemi njëmbëdhjetë, unë tani i informova Shefat e grupeve parlamentare për komunikimin tim me Ministrinë e Arsimit. Ne e kemi bërë pagesën e njëzet e katër punëtorëve për periudhën katër mujore, me vendimin e Kuvendit të Komunës në muajin gusht 2023, andaj unë ju ftoi që ta përkrahni propozimin tonë, sepse jemi të obliguar që ta gjejmë një zgjidhje për këtë çështje, sepse mësuesit e pranuar me konkurs publik janë në procesin mësimorë.

Nënkrjetari i Komunës: Normat tona janë në Komunën e Pejës, Suharekës, ku kemi rënie të numrit të nxënësve, andaj shteti duhet të gjen një zgjidhje përmes një reforme në pagesën e mësuesve, ndoshta edhe të përkohshme. Neve në muajin shtator të këtij viti na duhen edhe dyzet norma të reja në arsim.

Durim Hajra: Ne këtu duhet të flasim qartë për një realitet, ku ju keni qeverisur, shkaktarë i këtij keqë menaxhimi, këtu janë disa probleme, nuk është kontrolluar ndërtimi, është rritur trendi për shërbime shtesë, nuk keni nevojë ta merrni këtë personale, është punuar me vite pa një planifikim të mirëfilltë, me infrastrukturë sociale përcjellëse.

Vlonjat Hasani: Kur kërkohet të përkrahet një propozim-vendim, kërkesa duhet të jetë e qartë dhe të elaborohet e sqarohet, ne nuk e kemi asnjë shpjegim për dialogun dhe komunikimin me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 266,885.39€ nga buxheti i komunës, programi buxhetor i arsimit me Nr. 92010 prej kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve apo subvencioneve për pagesën e pagave të mësimdhënësve për vende të lira të punës dhe zëvendësime në vitin shkollorë 2023-2024.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim, e aprovuan 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 266,885.39€ nga buxheti i komunës, programi buxhetor i arsimit me Nr. 92010 prej kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve apo subvencioneve për pagesën e pagave të mësimdhënësve për vende të lira të punës dhe zëvendësime në vitin shkollorë 2023-2024' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 120, të datës 22.01.2024, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 266,885.39€ nga buxheti i komunës, programi buxhetor i arsimit me Nr. 92010 prej kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve apo subvencioneve për pagesën e pagave të mësimdhënësve për vende të lira të punës dhe zëvendësime në vitin shkollorë 2023-2024 si vijon:

1.1 Dy mësimdhënës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulëta;

1.2 Një mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Lartë;

1.3 Një Asistent për Fëmijët me Nevoja të Veçanta;

1.4 Njëzet e një mësimdhënës zëvendësues, të mësimdhënësve në pushim të lehonisë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulëta;

1.5 Tetë mësimdhënës zëvendësues, të mësimdhënësve në pushim të lehonisë në Shkollën e Mesme të Lartë dhe

1.6 Një zëvendësues sekretare, të sekretares në pushim të lehonisë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulëta.

2. Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të lejuara nga buxheti i komunës, e cekur në pikën një të vendimit, do të shfrytëzohen për pagesat e katër (4) normave të reja për mësimdhënës dhe për zëvendësimin e tridhjetë (30) mësimdhënësve për periudhën njëvjeçare të vitit shkollorë 2023-2024, sipas specifikacionit dhe llogarisë tabelare të Drejtorisë së Arsimit.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Komunitet e Regjionit të Prishtinës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për 'Shqyrtim Marrëveshjes për Bashkëpunim me Komunitet e Regjionit të Prishtinës'. Hap diskutimin.

Nënkryetari i Komunës: Kjo marrëveshje për bashkëpunimin e komunave, e ka marrë përkrahjen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si një projekt i përbashkëta që nuk është në kundërshtim me ligjin, në brendinë e saj parashihen disa fusha të zbatimit të saj, që janë shumë të dobishme për qytetarët e komunës tonë, andaj unë ju ftoi ta përkrahni.

Hasan Ismajli: Në mbledhjen e kaluar këtë propozim e ka sqaruar Drejtori i Planifikimit Urban, unë i kam pasur disa mospajtime në fushën e transportit, sepse i njoh, kam kërkuar emërtim të linjave të transportit sikur Komuna e Prishtinës, nëpër territorin e Komunës së Graçanicës dhe Komunën e Lipjanit, për lokacionet e cekura në marrëveshje, të njëjtat i kërkojmë edhe për komunën tonë në relacionet Prishtinë/Harilaç dhe Prishtinë/Parku i Pishave apo edhe Prishtinë/Bardh i Madh, kjo ka qenë vërejtja ime për përmirësime, këto përmirësime, nuk kanë mundur të bëhen në marrëveshjen e nënshkruar nga gjashtë Kryetar të Komunave, është thënë se ndryshimet do të bëhen në marrëveshje të veçanta, por baza e tyre është vetëm kjo marrëveshje.

Habib Mekolli: Secila germë e shënuar në këtë marrëveshje ofron diçka për banorët e komunave pjesëmarrëse, aty thuhet se planet e detajizuara do të rregullohen nga ekipet teknike të komunave për secilën fushë, ndryshimet duhet të bëhen te neni 3, ku ne kemi mungesë të hapësirave publike, por ne e kemi mundësinë për ta aprovuar këtë marrëveshje kornizë. Këtu interesat janë të ndryshme nëpër fusha të ndryshme, ku mund të bëhet ndërtimi i parkut solar, do të mbillen drunjtë në zonën Prishtinë/Obiliq.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Marrëveshjen Kornizë e Bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional e lidhur ndërmjet gjashtë komunave të Republikës së Kosovës si vijon: Kryeqyteti Prishtina, Komuna e Podujevës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Fushë-Kosovës, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit’.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovuan ‘Marrëveshjen Kornizë e Bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional e lidhur ndërmjet gjashtë komunave të Republikës së Kosovës si vijon: Kryeqyteti Prishtina, Komuna e Podujevës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Fushë-Kosovës, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit’ dhe mori:

V E N D I M

1. Miratohet Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional me Nr. 14-024/01-233042/23, të datës 15.12.2023, e lidhur mes 6 komunave të Republikës së Kosovës si vijon: Kryeqyteti Prishtina, Komuna e Podujevës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Fushë-Kosovës, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit.
2. Marrëveshja sipas pikës një të këtij vendimi është në kuadër të kompetencave vetanake të komunave në fjalë dhe ka për qëllim bashkërendimin e aktiviteteve ndër-komunale në mes kryeqytetit dhe komunave fqinje, në fushat të ndryshme me interes të përgjithshëm në funksion të krijimit të lehtësirave për mirëqenien e qytetarëve në sfera të ndryshme të jetës.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Marrëveshja Kornizë e bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional me Nr. 14-024/01-233042/23, të datës 15.12.2023, e nënshkruar nga Kryetarët e Komunave të caktuara si përfaqësues të institucioneve shtetërore të nivelit lokal, të cekura në nenin një të këtij vendimi.

Pika e shtatë (7) - Propozim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Miradi e Poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Miradi e Poshtme’. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Ju tani po e shihni një propozim të kompletuar, sepse është bërë nga një person privat, i cili e ka përgatitur dokumentacionin për legalizimin e pronës së tij, mirëpo qëndrimi ynë parimor është kundër, sepse jemi për ruajtjen e tokës bujqësore.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Miradi e Poshtme’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Miradi e Poshtme' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 752, të datës 16.11.2023, për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të evidentuar në ngastrën kadastrale Nr. P-72514027-00166-24, me sipërfaqe S=555m², arë e klasës së pestë, në Miradi të Poshtme, në rrugën 'Miradi', sipas certifikatës së pronës me Nr. 14-942-22699 për palën Gëzim Bullatovci
2. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për ndërtimin e objektit individual-shtëpi banimi.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtim 'Propozimin e Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje për ndërrimin e anëtarëve të tyre në Komitetet të Kuvendit'. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Prpozimi ynë për ndryshime është si vijon: unë kaloi në Komitetin për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, ndërsa në Komitetin për Politikë dhe Financa vjen z. Vlonjat Hasani, në Komitetin për Komunitete vjen znj. Doruntina Jashari, ndërsa në Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Infrastrukturë shkon z. Shpend Bardiqi, në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kalon z. Habib Mekolli.

Hasan Ismajli: Me Statutin e Komunës, në Komitetin për Komunitete janë nëntë anëtarë, ndërsa në Komitetin për Politikë dhe Financa janë vetëm shtatë anëtarë, pse ju e keni lejuar këtë ndryshim, kur e kemi vetëm një udhëzim administrativ për rregullimin e kësaj pune, unë e kundërshtoi përfaqësimin në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku janë tre përfaqësues të LDK-së, dy përfaqësues të Vetëvendosjes dhe një i PDK-së, ndërsa në këtë komitet të përhershëm pa të drejtë nuk përfaqësohen Nisma Socialdemokrate dhe subjektet tjera sipas radhës, në Komitetin për Komunitete janë të përfaqësuar subjektet politike shqiptare, ku LDK-ja e ka një anëtare jashtë Kuvendit të Komunës, atëherë është propozuar, për ta përfituar një kompenzim prej: 50.00€.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Politikë dhe Financ, në vendin tim z. Vlonjat Hasani'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', dy votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Politikë dhe Financa, në vendin tim z. Vlonjat Hasani' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar e z. Durim Hajra nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe për caktimin e z. Vlonjat Hasani në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë si: shqyrtimin e politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Komunitete, vjen znj. Doruntina Jashari në vendin tim z. Shpend Bardiqi’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, dy votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovoi ‘Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Komunitete, vjen znj. Doruntina Jashari në vendin tim z. Shpend Bardiqi’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Shpend Bardiqi nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e znj. Doruntina Jashari në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t’u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vjen z. Habib Mekolli në vendin e znj. Doruntina Jashari’.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim e aprovoi ‘Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vjen z. Habib Mekolli në vendin e znj. Doruntina Jashari’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar znj. Doruntina Jashari nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z.Habib Mekolli në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Infrastrukturë, vjen z. Shpend Bardiqi në vendin e z. Habib Mekolli'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Infrastrukturë, vjen z. Shpend Bardiqi në vendin e z. Habib Mekolli' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 94, të datës 31.03.2022 për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, për ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Habib Mekolli nga përbërja e Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Shpend Bardiqi në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 94, të datës 31.03.2022, për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 6, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, vjen z. Durim Hajra në vendin e z. Vlonjat Hasani'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Komitetin për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, vjen z. Durim Hajra në vendin e z. Vlonjat Hasani' dhe mori:

V E N D I M


1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 51, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Vlonjat Hasani nga përbërja e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Durim Hajra në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 51, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 7, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Qëndresa Ademi: Unë tani jam përfaqësuese e komunitetit ashkali, por atëherë e kemi propozuar znj. Linda Hyseni për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës; Sqaroi se në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ju jeni regjistruar si Iniciativa e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali IFKEA.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 14:55 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIONE

Nrfaq/Dr.str. 55
Datë/Datum. 18.04.2024

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e dytë -II e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.02.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Vjosa Kida Hyseni - Drejtoreshë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 31.01.2024.
2. Propozim për rritje të buxhetit nga të hyrat vetanake të vitit 2023.
3. Propozim për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2023 për shpenzim në vitin 2024.
4. Propozim për lirimin e subjekteve afariste nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Rishqyrtimi i shkresës Nr. 0-360/1, të datës 13.02.2024 për Rregulloren e Transparencës Nr. 228, të datës 29.12.2023.
6. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me kalendarin vjetor të organizimeve dhe aktiviteteve në kulturë dhe sport për vitin 2024.
7. Propozim për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë.
8. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje, lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës, me konstatimin se pika e katërt e rendit të ditës, është tërhequr nga shqyrtimi në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe shqyrtimin e pikës shtesë nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin për rendin e ditës.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim rendin e ditës me kërkesën për tërheqjen nga shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave' dhe pranimin e kërkesës për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne jemi dakorduar që të shqyrtojmë vetëm pika shtesë që janë urgjente, sikur ka qenë statute unik për shëndetësi, ndërsa vendimi për 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave', ne nuk jemi pajtuar me këtë, tjetër pse pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', është zhvendosur në fund, kjo punë e rëndon raportin tonë pozitiv/opozitë, ne si opozitë do të jemi të detyruar të marrim masa tjera, të cilat jeni duke i nxitur ju vetë, këto masa do të mirren nga mbledhja e ardhshme, andaj ne kërkojmë që pika e pyetjeve, ku ne i paraqesim shqetësimet e qytetarëve të kthehet në fillim sipas 'Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', sepse anëtarët e Ekzekutivit të Komunës largohen nga mbledhja në gjysmën e saj.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Të gjithë ne e dijm se 'Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', e kemi aprovuar me votim unanim, me pajtimin edhe tuajin z. Laureat Gojnovci si përfaqësues i pozitës në Kuvendin e Komunës dhe në Grupin Punues për hartimin e planit të punës, kujt po i pengon zbatimin e këtij plani, kjo po shihet, ne kemi pasur diskutime për respektimin e kohës, dihet kush e zgjatë diskutimin në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, pse ka tendencë të prezantohen këtu qëndrimet e Ekzekutivit të Komunës, i cili me mos prezencën e tij nuk e respekton Kuvendin e Komunës, pse ne duhet ta marrim si të mirëqenë këtë punë në bazë të tyre. Tani ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, duhet të jeni më të kujdesshëm, të mos e ndryshoni radhitjen e pikave të rendit të ditës, mos na detyroni neve për veprime tjera, mos na obligoni neve të bëjmë shprehjen e lirë në mënyrë tjetër në mbledhjen e ardhshme, ju duhet ta mbani nivelin herën tjera.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për planin e punës së kuvendit të Komunës për vitin 2024, kemi diskutuar gjatë në dy takime të punës, e falënderojmë edhe Shefin e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Laureat Gojnovci, ku me pajtimin e të gjithëve jemi dakorduar për strukturën e planit dhe radhitjen e pikave, pse tani e kemi këtë vendim të pa pritshëm, ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, duhet ta ruani kredibilitetin tuaj dhe tonin, të zbatoni planin e punës të votuar unanimisht këtu, të mos lejoni ndërhyjen e Ekzekutivit të Komunës në zbatimin e planit tonë të punës, sepse punët e organeve të komunës janë të ndara, këtu Kryetari i Komunës nuk vjen asnjëherë, që nga dhënia e deklaratës së betimit, tani edhe Nënkryetari i Komunës nuk po vjen, nuk kemi kujt t'i paraqesim pyetjet tona në fund të mbledhjes, sepse anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, edhe ata drejtor që janë prezentë në fillim të mbledhjes, nuk qëndrojnë deri në fund të saj. Unë do të parashtroi pyetjen time për ndarjen e subvencioneve në arsim, për studentët e komunitetit serb, që i vijojnë studimet e tyre në Universitetin e Mitrovicës së Veriut,

me plan-programin e Serbisë dhe me dokumentacion jo kushtetues për vendin tonë, e marrin subvencione në arsim, kjo punë është e pa pranueshme. Ju tani Kryesues, jeni duke e shkelur planin e punës së Kuvendit, andaj unë kërkoi që të hidhet në votim kthimi i pyetjeve në vendin e tyre sipas planit të punës së Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Është e vërtetë që pyetjet janë pika e dytë sipas planit të punës, por ju do ta keni kohën e duhur për parashtrimin e tyre sipas 'Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës'.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Të gjithë ne që kemi qenë pjesëmarrës në punën e Grupit Punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit, jemi dakorduar për strukturën e planit të punës, si orientim për punën tonë një vjeçare, nëse ky plan nuk respektohet ne ndihemi të ofenduar. Unë kërkoi që si pikë e rendit të ditës të jetë edhe propozimi për plotësimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, meqë tani dy drejtor anëtarë të këtij komisioni të caktuar në fillim të vitit 2022, nuk janë pjesë e komisionit, andaj ne nuk po mund të vazhdojmë punën tonë.

Artan Asllani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Dua të sqaroi se ne në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, e kemi proceduar për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave', sepse nuk e kemi marrë asnjë sqarim, për kërkesën e Ekzekutivit të Komunës, si dhe e kemi bërë një rekomandim tjetër që ta kemi një deklaram formal të anëtares së deritashme të Komitetit për Komunitete znj. Linda Hyseni, andaj kërkohet që kjo çështje të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme.

Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që pika për ndryshimin e anëtarëve në kuadër të Komitetit për Komunitete, i parashtruar si propozim nga ne, të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë dua ta sqaroi kërkesën për tërheqjen e pikës së katërt të rendit të ditës nga shqyrtimi, meqë Grupi Punues është duke i shqyrtuar tarifat e reja për marrjen e mbeturinave, ju e dini funksionimin e Kompanisë Rajonale për Mbeturina 'Pastrimi', ku Njësia e Fushë-Kosovës punon si e ndarë në teren, por menaxhimi financiar dhe operativ ndodh në kuadër të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave, ku komunat tjera i kanë ndryshuar tarifat për marrjen e mbeturinave, si rezultat i shumë faktorëve të operimit dhe funksionalitetit të tyre.

Mirsad Qyqalla: Kjo punë nuk duhet të shkon kështu, por votimi i shumicës e ndryshon gjendjen, por kjo mënyrë e trajtimit të punës dhe tërheqjes së pikave të rendit të ditës, sikur kjo për anëtarë të Komitetit për Komunitete nuk është në rregull fare, sepse këtu kemi të bëjmë me një trup legjislativ.

Laureat Gojnovci: Tani pikat e rendit të ditës sipas ligjit caktohen, me dakordim dhe konsultim ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe këtë punë duhet ta dini të gjithë. Plani i punës nuk e definon secilën çështje sa i përket pikave shtesë, sepse dihet e drejta për propozime ose edhe për tërheqjen e një pikë të caktuar nga propozuesi, tani propozuesit e kanë mirëkuptimin tonë për tërheqjen e pikave të tyre nga shqyrtimi.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e uroi Drejtoreshën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për detyrën e re dhe i dëshirojmë suksese në punë. Këtu tërheqja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, bëhet nga ai me kërkesën e Ekzekutivit të Komunës, për të ruajtur votat e pozitës, sepse z. Bashkim Krasniqi realizon shumë të drejta nga

pushteti komunal, bënë udhëtime të ndryshme dhe merrë mëditje me dokumente zyrtare të Serbisë, kjo punë është e pa pranueshme.

Durim Hajra: Ne në diskutimet tona duhet të jemi racional, por duke respektuar rregullat, ne nuk pajtohemi me zhvendosjen e pyetjeve në fund të rendit të ditës, sepse kjo paraqet ndërhyrje në punën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve për procedurat, e qiti në votim 'Propozimin për tërheqjen e pikës së katërt për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër', dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi tërheqjen nga rendi i ditës të shqyrtimit të dytë pikën e katërt 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave'.

Pas sqarimeve për procedurat, e qiti në votim propozimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Bashkim Krasniqi për tërheqjen e pikës së shtatë nga rendi i ditës 'Shqyrtimi i kërkesës Nr. 390, të datës 13.02.2024 për ndryshimin e anëtarit në përbërjen e Komitetit për Komunitete'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër', dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi tërheqjen nga rendi i ditës të shqyrtimit të pikës së shtatë nga diskutimi 'Shqyrtimi i kërkesës Nr. 390, të datës 13.02.2024 për ndryshimin e anëtarit në përbërjen e Komitetit për Komunitete'.

Pas sqarimeve për procedurat, e qiti në votim propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shqyrtimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe katër abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për shqyrtimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Pas sqarimeve për procedurat, e qiti në votim kërkesën që 'Pika pyetje dhe përgjigje parlamentare', të kthehet si pikë e dytë e rendit të ditës.

U votua me: shtatë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e refuzon kërkesën që 'Pika pyetje dhe përgjigje parlamentare', të kthehet si pikë e dytë e rendit të ditës.

Pas sqarimeve për procedurat, e qiti në votim për aprovim rendin e ditës me pikat e tërhequra nga shqyrtimi dhe me pikën shtesë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shqyrtimin

në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', nëntë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi rendin e ditës me pikat e tërhequra nga shqyrtimi dhe me pikën shtesë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shqyrtimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.01.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit të Kuvendit të Komunës e datës 30.01.2024', ju ftoi për të dhënë komentet e juaja për ndonjë vërejtje apo sugjerim tuajin.

Durim Hajra: Ne kërkojmë që të respektohet Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, të bëhet publikimi i audio incizimeve, ju si Kryesues i Kuvendit të Komunës duhet të merrni hapa konkret për respektimin e 'Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës', ne tani jemi në mbledhjen e njëzet e gjashtë me radhë në këtë mandat dhe kjo punë nuk po ndodh.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kam bërë përpjekje që pjesërisht të zbatohet ligji, por kjo punë nuk varet vetëm nga unë, e kemi incizimin me kamerë 3 D, jemi të vetëdijshëm edhe për kërkesën për përkrahjen nga Shoqëria Civile, unë jam këtu për njëmbëdhjetë vite, kjo punë nuk është ndryshuar në substancën e saj, unë e kam ngritur edhe zërin e juaj, por kjo punë duhet të rregullohet nga ana e Ekzekutivit të Komunës, unë jam që Ligji për Vetëqeverisje Lokale të zbatohet i plotë.

Mirsad Qyqalla: Kujt po i kontribuon ky terr informativë është e qartë, por është edhe obligim i juaji i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, që të ballafaqoheni me një pjesë të përgjegjësisë, ju na përfaqësoni neve, andaj duhet të rezistoni dhe të mos lejoni që pyetjet të barten në fund të rendit të ditës, nuk mjafton vetëm të shfajësoheni.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 30.01.2024.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', nëntë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Komunës në mbledhje, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtura me datën 30.01.2024.

Pika e dytë (2) - Propozim për rritjen e të hyrave vetanake të buxhetit të vitit 2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përsëhendes të pranishmit në mbledhje. Sqaroi shumat e mjeteve financiare të parapara nga rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake të grumbulluara në vitin 2023, për secilën kategori ekonomike dhe shpërndarjen e tyre për shpenzim në kodet e programeve buxhetore, me kërkesën e rekomanduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, për ndarjen e shumës shtesë të mjeteve financiare prej: 20,000.00€ për 'Dixhitalizimin e Sallës së

Kuvendit të Komunës', që tani e arrin shumën e mjeteve financiare prej: 30,000.00€ në tabelën numër dy tek bartja e buxhetit, ku janë projektet kapitale.

Migjen Kolshi: Sa mjete financiare janë të ndara tani për Palestrën e Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël, për zhvillimin e aktiviteteve dhe përgatitjeve për gara kampionale të sportistëve të komunës tonë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Tani për Palestrën e Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël nga bartja e buxhetit të pa shpenzuar në vitin 2023, është në shumën e mjeteve financiare prej: 1,551,675.66€, me bartjen e buxhetit do të realizohen projektet e filluara tre vjeçare, për të cilat janë kontratat e lidhura.

Laureat Gojnovci: Tani kur janë të lidhura kontratat me operatorët ekonomikë për mbi 4 milion euro, kjo i bjen që 52% e buxhetit është në procedurë të zbatimit dhe realizimit të projekteve kapitale, kjo punë është mirë, sepse këto kontrata do të realizohen dhe nuk mund të ndalen nga ankesat në organin përkatës të prokurimit publik. Nga rritja e buxhetit të komunës për vitin 2023, për subvencione parashihet shuma e mjeteve financiare prej: 184,366.74€, kemi një rritje prej: 45,000.00€ ose 11.56%, në shumën prej 94,823.28€ në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, e kemi zvogëluar për 20,000.00€, të cilat janë bartur në projektin për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit të Komunës', në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, te projektet kapitale kemi rritje prej 48%, ku shuma totale 100% shkon për rregullimin e 'Palestrës së Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël', unë në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohem me këtë shpërndarje dhe rritjen e buxhetit, po ashtu kërkojmë nga Drejtoritë e Komunës realizimin e këtij buxheti të rritur në vitin 2023, që parashihet të shpenzohet në vitin 2024.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kërkojmë që ta dijm burimin e grumbullimit të këtyre të hyrave vetanake, ta kemi një informatë të zgjeruar, sepse ne konsiderojmë se mos shpenzimi i buxhetit në shuma të mëdha, me miliona, paraqet një keqë-planifikim ose mos-planifikim, supozimi ynë është se këto mjete financiare vijnë kryesisht nga lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë, por këto mjete financiare nuk kthehen në investime në infrastrukturë për qytetarët, po ashtu e njëjta vlen edhe për tatimin në pronë, ku pagesat e realizuara nuk u kthehen qytetarëve, ju nuk e keni pranuar propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje për faljen e njëqind eurove të tatimit në pronë për qytetarët e komunës tonë, ndërsa në anën tjetër nga viti 2017, e bëni lirimin e bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, të cilën pikë e kemi edhe sot në shqyrtim. Kemi një shpërndarje jo të drejtë të projekteve në qytet krahasuar me fshatrat e komunës, ku shkojnë shumica e investimeve publike.

Mirsad Qyqalla: Ne e kemi të qartë tavanin që e cakton Ministria e Financave për të hyrat vetanake të komunës, kjo rritje ndodh nga lejet e ndërtimit, por neve na bëhet e rëndë mirëqenia, sepse nuk përcillet zhvillimi me investime në interesin publik, sidomos në zonat e urbanizuara të qytetit mungojnë investimet dhe kjo qasje e komunës shkakton shumë probleme për qytetarët. Subvencionet ndahen për Organizata Jo Qeveritare dhe individë, përfituesit janë në masë të madhe pa meritë. Ne si Kuvend nuk kemi informata zyrtare, as për investimet publike, as për përfituesit e subvencioneve, nuk e kemi një raport për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve financiare.

Hasan Ismajli: Rritja e buxhetit të komunës vjen nga lejet e ndërtimit dhe legalizimi i objekteve pa leje ndërtimore i cili ka filluar, si dhe tatimi në pronë, mirë po ndarja e tyre po bëhet në interesin e pushtetit dhe nuk dihet kah shkojnë këto mjete financiare.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam qenë prezentë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, e ka bërë arsyetimin për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake, por propozimin e ka paraqitur në dy faqe, apo një fletë A 4, ku buxhet duhet të shkon aty ku kërkohet nga qytetarët e komunës, ndahen mjete financiare për mësimin joformal, ku ne nuk kemi të dhëna sa është ky buxhet, sa marrin mësimdhënësit që e zhvillojnë këtë proces mësimorë, nuk dihen shumat që shkojnë për bursa të studentëve, për rastet sociale, pra të gjitha këto kanë mundur të na jepen neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës në një sistem të programit exel. Kjo punë do të bëhet shumë thjeshtë, çka duhet të përkrahet, çka duhet të kundërshtohet, për të patur më të lehtë procesin e votimit, mirëpo për fatin tonë të keqë dhe pamundësinë e investimeve që kërkohen në teren, ju këtë menaxhim fatë keq e kini në dorë dhe atë po e bënë në mënyrën jo të duhur për interesin e qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve e qiti në votim 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake të buxhetit të vitit 2023'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për rritjen e të hyrave vetanake të buxhetit të vitit 2023' dhe mori:

V E N D I M

1. Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 389,203.44€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej: 15,176.72€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa - 11, në kodin e programit Administratën e Arsimit me numër 92010;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej: 164,366.74€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, në katër kode të programeve.
 - 1.2.1 Në Infrastrukturë Publike, programi 18162, shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€;
 - 1.2.2 Në Mirëqeni Sociale, programi 75506, shuma e mjeteve financiare prej: 45,000.00€.
 - 1.2.3 Në Kulturë Rini dhe Sport, programi 85002, shuma e mjeteve financiare prej: 74,823.28€
 - 1.2.4 Në Administratën e Arsimit, programi 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 34,543.46€ dhe
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej: 209,659.98€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike investime kapitale - 30, në kodin e programit dhe kodin e projektit:
 - 1.3.1 Në Kulturë Rini dhe Sport, programi 85002, për projektin 'Palestra Sportive në fshatin Sllatinë e Vogël', kodi ekonomik i projektit me numër 51386, shuma e mjeteve financiare prej: 189,659.98€;
 - 1.3.2 Në Administratë, programi 16302 'Dixhitalizimi i Sallës së Kuvendit Komunal në Fushë-Kosovë', kodi ekonomik i projektit 49135, shuma e mjeteve financiare prej:

20,000.00€.

2. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej: 389,203.44€ nga paragrafi 1, të zbërthyer në nën paragrafin 1.1 - në kategorinë paga dhe shtesa në Administratën e Arsimit shpenzohen për mbarëvajtje të procesit mësimorë për mësimin joformal, nënparagrafi 1.2 - në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere, nënparagrafi 1.2.1 në Infrastruktura Publike shpenzohen për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, nënparagrafi 1.2.2 në Mirëqenie Sociale shpenzohen për qiratë e rasteve sociale, nënparagrafi 1.2.3 në Kulturë Rini dhe Sport shpenzohen për përkrahje financiare të Organizatave Jo Qeveritare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, nënparagrafi 1.2.4 në Administratën e Arsimit shpenzohen për ndihma për studentë, paragrafi 1.3 - nënparagrafi 1.3.1 në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale, në programin Kulturë Rini dhe Sport, shpenzohen në kodin e projektit për 'Palestrën Sportive në fshatin Sllatinë e Vogël' dhe nënparagrafi 1.3.2 shpenzohen për kodin e projektit për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit Komunal në Fushë-Kosovë'.

Pika e tretë (3) - Propozim për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2023 për shpenzim në vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim 'Propozimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2023, për shpenzim në vitin 2024', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Tani Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, ka përgatitur buxhetin e pa shpenzuar në kategoritë ekonomike dhe programet buxhetore të vitit 2023, për shpenzim në vitin 2024, duke u mbështetur në nenin 9 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, duke e bërë ndarjen dhe rindarjen e tij, për paga dhe mëditje në shumën e mjeteve financiare prej: 15,175.72€, për subvencione dhe transfere në shumën e mjeteve financiare prej: 184,366.74€ dhe për investime kapitale në shumën e mjeteve financiare prej: 5,829,491.61€, prej tyre shuma e mjeteve financiare prej: 4,051,000.00€, për arsye të vonesave të qeverisë në bartjen e buxhetit deri në muajin gusht 2023, nuk ka mundur të realizohet, pastaj sikur e dimi e kemi të pamundur ta shpenzojmë buxhetin e komunës që grumbullohet në muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit fiskal, për arsye të kohëzgjatjes së procedurave të prokurimit publik dhe mbylljes së buxhetit.

Laureat Gojnovci: Për bartje si buxhet i pa shpenzuar e kemi një shumë të mjeteve financiare në totalin e saj prej: 6.3 milion euro, kjo shumë duket e lartë, por kur e dëgjojmë sqarimin e Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe buxhetit, se mjete financiare të kontraktuara për shpenzim janë në shumë prej: 4,051,000.00€, po ashtu edhe grumbullimin e të hyrave vetanake që në tremujorin e fundit të vitit e kapin shumën e mjeteve financiare prej: 900,000.00€, po ashtu kur e marrim parasysh edhe faktin e vonesës së zhbllokimit të buxhetit të komunës nga të hyrat vetanake, vetëm në muajin gusht të vitit 2023, për arsye që të gjithë i dijmë dhe i kemi të njohura, kur i marrim parasysh të gjitha këto fakte, që kanë ndodhur vitin e kaluar, ne e përkrahim për aprovim bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të komunës në vitin 2023, për shpenzim në vitin 2024. Pajtohemi plotësisht edhe me shpërndarjen e buxhetit ku 92% e tij shkon për projekte kapitale, që ndikon direkt në mirëqenien e qytetarëve të komunës në shumë fusha me interes për banorët e komunës

tonë, për qytetin dhe fshatrat e komunës. Nëse hyjmë në projektet kapitale ndarazi, tani parashihen projekte kapitale me mbi një milion euro sikur është projekti i rregullimit të rrjetit të kanalizimit, si infrastrukturë për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, pastaj Palestrën Sportive për sportistët e komunës tonë, ndërtimin e shkollës së re në shumën e mjeteve financiare prej: 470,725.02€, pastaj e kemi shumën e mjeteve financiare prej: 150,000.00€ për Palestrën e Notit, kemi vazhdim të projekteve të asfaltimit me mjetet e mbetura financiare dhe buxhetin e planifikuar për vitin 2024, ndërtimin e përrockave të lumenjëve, në fund për subvencione i kemi rreth 4% të buxhetit.

Durim Hajra: Kjo qasje e shpenzimit të ulët të buxhetit dhe shpërndarja e tij, është e gabuar, tani Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, e ceku edhe bazën ligjore për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar, ne tani i kemi kaluar dy vjet mandat në Kuvendin e Komunës, edhe ata që janë më të rinj, nuk kemi nevojë për këtë qasje formale, por kemi nevojë për sqarime të duhura, pse buxheti nuk është shpenzuar me kohë, pse e kemi për bartje këtë shumë kaq të lartë të pa shpenzuar të buxhetit. Këtu po bartet si e pa shpenzuar 42% e buxhetit total të komunës, ose shuma e mjeteve financiare që bartet si e pa shpenzuar për projekte kapitale është 110% dhe ky është një fenomen i keqë, kjo punë ndodh vetëm në Komunën e Fushë-Kosovës, arkëtimi i të hyrave vetanake duhet të kthehet në investime publike, të mos ngecim, unë në fillim kur kam qenë në mandatin e parë buxheti i bartur si i pa shpenzuar ka qenë tre milion, tani kjo shumë është rritur në gjashtë milion, duhet të shqyrtohen shkaqet pse po ndodh kjo, shumica e mjeteve financiare që barten si të pa shpenzuara janë për projekte kapitale, që do të thotë më pak investime në rrjetin e kanalizimit në qytet, më pak trotuare, më pak ndriçim publik, i cili është shumë jofunksional, edhe aty ku është investuar, me pak hapësira publike, mungesë të sheshit, që bartet si projekt për më shumë se pesë vjet, ne kemi ardhur në përfundim se janë tre faktor kryesorë, që ndikojnë në mos shpenzimin e buxhetit që e kemi në disponim, e para është keqë-planifikimi i buxhetit, e dyta keqë-menaxhimi i buxhetit dhe në fund e treta mos përfshirja e qytetarëve në procesin e vendim marrjes publike. Kur mungon komunikimi me publikun normal se vjen deri te kjo bartje e buxhetit të pa shpenzuar, me miliona, projektet e premtuara 90% e tyre nuk janë realizuar, parashihen njëjtë projekte për asfaltime pa kur farë ndryshimi në qasje, edhe në projektet që kryhen shumë herë dështon realizimi si duhet i tyre, sepse mungon mbikëqyrja e projekteve. Po ashtu ne duhet ta dijm si anëtarë të Kuvendit të Komunës, edhe sa mjete financiare janë humbur që kanë shkuar në suficit, si buxhet i pa shpenzuar, që janë nga granti qeveritarë, janë mjete financiare të pakthyeshme, kjo shumë është 250,000.00€, si shkak i neglizhencës tuaj.

Mirsad Qyqalla: Tani këtu shumica këtu u thanë nga parafolësi im, u vendos një fajësi për mos shpenzimin e buxhetit të komunës, e mbështetur në disa faktor, këtu justifikim nuk ka, ne e kemi votuar buxhetin e komunës, që ai të kthehet në investimet publike, këtu nga tabela e shpenzimeve vërehet që disa Drejtori të Komunës janë jashtë funksionit të tyre, këtu hyn projekti që nuk realizohet 'Dixhitalizimi i Sallës së Kuvendit të Komunës', në shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€, pastaj projekti i sheshit të lagjes 'Dardania', që bartet nga viti në vitë, u tha këtu nga përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Laureati, se do të ndërtohet edhe Palestra e Notit, edhe ne i gëzohemi këtij projekti publik, por të gjithë e kemi parë dështimin në ndërtimin e Sallave të Sportit, në shumicën e fshatrave tona mungon rrjeti i ujësjellësit, edhe pse qysh para një dekade është premtuar rregullimi i këtij problemi për qytetarët e komunës tonë, edhe pyllëzimi prej: 15,000.00€ nuk është realizuar, e lëre më projektet në shumën prej: 200,000.00€, që janë një dështim i plotë në investime, këtyre fakteve dhe realizimit të projekteve publike në këtë mënyrë,

nuk ke si t'i quajmë ndryshe, vetëm se keqë-planifikim i buxhetit dhe keqë-menaxhim në realizim të projekteve kapitale. Nëse del në teren e sheh një ndriçim publik jo funksional, mungojnë parqet dhe këndet e lojërave për fëmijë, palestrat e sportit janë jo funksionale, edhe pse projektet kanë përfunduar, kur kësaj i shtohet edhe suficiti nga grandit qeveritar, kur kemi mungesë të Kryetarit të Komunës, tani edhe të Nënkretarit të Komunës për ballafaqim në Kuvendin e Komunës, ne i kemi për shqyrtim këto propozime me letrat e juaja, por edhe me kërkesat e qytetarëve për rregullim të çështjeve të tyre në teren, por sikur po shihet këtu mungon vullneti për punë në interesin publikë, ne nuk kemi mekanizëm tjetër në dorë, përveç paraqitjes, vënies në dukje të keqë-qeverisjes tuaj, të keqë-planifikimit dhe keqë-menaxhimit të buxhetit të komunës, ku po bartim mbi gjashtë milion euro të pa shpenzuar, kur nevojat e qytetarëve për investime në shumë fusha janë të mëdha.

Hasan Ismajli: Këtu bartja e buxhetit të pa shpenzuara në numra është 6.3 milion euro, e kemi edhe një shpërndarje që na është dhënë nga Ekzekutivi i Komunës, por këtu nuk po e shoh shumë e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ për ndërtimin e fushës së sportit në lagjet e komuniteteve 028 apo 029, ku atje nuk ka pronë komunale, prona është e Hekurudhës, kjo pronë kërkohet për tre vjet, tani propozohet të ndërtohet edhe 'Palestra e Notit', që është mirë për sportistët e komunës nëse realizohet, kur të gjithë ne i kemi parë problemet në ndërtimin e Sallave të Sportit, në hapësirën e ndërtimit të Sallës së Sportit në oborrin e objektit të shkollës 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë, kemi tjetërsim të pronës, unë ju them se fusha e sportit në lagjen 028 nuk do të ndodh. Rregullimi i sheshit në lagjen e 'Dardanisë' në Fushë-Kosovë në shumë e mjeteve financiare prej: 735,746.47€, atje tani është planifikuar një projekt për mbjelljen e 150 pemëve dekorative, që do të mbillen atje dhe dikun 10 m2 bari, por shesh aty nuk pritet të ketë asnjëherë. Në secilin vitë parashihet ndërtimi i urave të lumenjëve, por ato nuk po shihen në teren.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve e qiti në votim 'Propozimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2023, për shpenzim në vitin 2024'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', nëntë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2023, për shpenzim në vitin 2024' dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2023, në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 6,318,133.88€, sipas propozimit dhe përshkrimit në dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 394, të datës 13.02.2024, me ndryshimet e propozuara në Kuvendin e Komunës për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës', të prezantuara në formën tabelare prej dy faqeve - pjesë e këtij vendimi.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 15,176.72€
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 220,944.60€;

- 2.3 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 232,520.95€;
- 2.4 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 5,849,491.61€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit dhe shpenzimet janë të detajizuara dhe të përshkruar, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

Pushim në kohëzgjatje prej 1 orë.

Pika e katërt (4) - Propozim për lirimin e subjekteve afariste nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lirimin e subjekteve afariste për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik që të na jap sqarime.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Përsëhendes të pranishmit në mbledhje. Ky lirim nga taksat e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, pritet të ndikon në zhvillimin ekonomik lokal, ne i kemi ndihmuar bizneset e komunës që nga viti 2017, këtu fjala është për 2750 biznese, të cilat kanë vende të punës funksionale, synimi ynë si komunë mbështetur në kompetencat tona, në kohën e tanishme është ruajtja e vendeve të punës së bizneseve aktuale dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës të bizneset e reja. Ne e kemi krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e biznesve në komunën tonë, tani në fshatin Miradi e Epërme është ndërtuar infrastruktura e 'Parkut Industrial', ku do të vendosen shumë biznese, unë tani ju ftoi juve, që ta përkrahni propozimin në fjalë për lirimin e subjekteve afariste nga taksat komunale të biznesit.

Laureat Gojnovci: Tani këtu Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik i dha sqarimet dhe faktet e saj, për krijimin e një klime të mirë për zhvillimin e bizneseve, për të cilat do të krijohen lehtësime për bizneset e reja, por edhe për bizneset aktuale, andaj ne në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për lirimin e subjekteve afariste nga taksat e bizneseve komunale për periudhën tre vjeçare në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Habib Mekolli: Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik do të duhet të na sillte neve një material voluminoz, e jo një fletë A 4, e me atë të kërkohet përkrahja e bizneseve, ndërsa si arsyetim merret gjendja e rënduar ekonomike, madje lirimi kërkohet deri në vitin 2025, ndërsa nuk mendohet fare për uzurpimin e hapësirave publike nga bizneset e ndryshme, në ndërtesat shumëkatëshe, ku qytetarët nuk kanë as ku t'i parkojnë automjetet e tyre. Në komunën tonë kemi edhe Kompani të mëdha, edhe me mbi tridhjetë punëtorë, biznese të fuqishme në disa fusha, si të ndërtimit e shërbimeve tjera, ky lirim në bllok nuk është i drejtë, këtu duhet të kemi parasysh dhe të jemi të vetëdijshëm edhe për konfliktin e interesit.

Mirsad Qyqalla: Edhe ne në parim jemi që të ndihmohen bizneset e komunës tonë, por me kritere duke u mbështetur në fuqinë ekonomike të tyre, këtu nëse e marrim një kalkulim të thjeshtë fjalë është 2750 biznese, del se lirimi do të jetë gjysmë milion euro në vitë, u përmend edhe gjendja e rënduar ekonomike, por në dokumentet e qarkullimit ekonomik, kemi biznese me fitime me miliona, sikur është edhe subjekti afaristë 'Labi Oill', pastaj 'Viva Freshi', por edhe shumë biznese tjera të fuqishme, këto biznese kanë profit ekonomik dhe nuk kanë nevojë për ndihmën e komunës,

por vetëm për rregullimin e kushteve të operimit të drejtë në tregun e lirë. Logjika e lirimit të bizneseve nga taksat komunale, e ka një aspekt njerëzorë, të cilin duhet të shoh në veprimet e saj Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, sa prej këtyre bizneseve janë mikro biznese, biznese të vogla, që kanë nevojë për ndihmë, sa janë biznese të mëdha, sa janë biznese të furnizimit, sa janë biznese që e dëmtojnë ambientin. Komuna këtu po bënë politikë me bizneset, duke i ndihmuar të gjitha pa asnjë dallim, disa prej tyre kur i pyet ndonjë televizion, as nuk dijnë për këtë fakt, lirimit e bizneseve nga taksat komunale, meqë ju po veproni në këtë formë, ne nuk mund ta përkrahim këtë propozim të Ekzekutivit të Komunës, pa e bërë një ndarje të bizneseve sipas kapitalit ekonomik e human dhe qarkullimit të tyre financiarë në tregun e lirë, e që veprimtarinë e tyre ekonomike e zhvillojnë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Hasan Ismajli: Komuna e Fushë-Kosovës që nga viti 2017, e ka bërë lirimin e bizneseve nga taksat komunale, ndërsa në vitin 2022 e ka bërë faljen e bizneseve për periudhën 2009-2016, ndërsa tani e kërkon lirimin e tyre për vitet 2023-2025, për 2750 biznese që vetëm nëse falen vetëm nga 200.00€ , kur mbledhet kjo del shuma e saktë që bizneset lirohen nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë biznese. Këtu po falen pomat e benzinës që kanë qarkullim të madh, pastaj marketet e mëdha, që qarkullojnë dhjetëra mijëra euro brenda ditës, madje në kohën e krizës dhe pandemisë kanë patur qarkullim edhe më të madh në tregun e lirë, sepse kanë funksionuar mirë, janë ndihmuar edhe nga niveli qendror në emër të pagave të punëtorëve. Bizneset e komunës në vitin 2020 janë ndihmuar edhe nga Komuna e Fushë-Kosovës, nga shuma e përgjithshme prej: 690,000.00€ nga fondi rezervë për menaxhimin e pandemisë, po ashtu nga Ekzekutivi i Komunës janë ndihmuar edhe me shumën e mjeteve financiare prej: 404,000.00€, në fillimin e pandemisë në pranverën e vitit 2020, përmes fitimit të tenderëve, ndërsa ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk e kemi pasur në shqyrtim asnjë raport për këto shpenzime. Lirimi i bizneseve po bëhet, se juve ju ka ardhë në mendje, humbja e zgjedhjeve, sigurimi i votave, në mënyra të ndryshme, përkrahja në kohën e zgjedhjeve, andaj edhe lejohen shumë leje ndërtimore, kemi uzurpime të terrasave, andaj e kemi një ndryshueshmëri të madhe dhe pa vizion të këtij Ekzekutivi të Komunës.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në parim ne jemi për përkrahjen e bizneseve, andaj e kemi propozimin për lirimin e bizneseve nga taksat komunale, por ne kërkojmë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, që të kemi sqarime shtesë, ky tekst i propozuar nuk ka qartësi, lidhur me konfliktin e interesit që u theksua këtu nga përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje, ne jemi legjislaturë e re këtu dhe duhet ta analizojmë faktet. Unë flas këtu si anëtarë i Kuvendit të Komunës, jo në emër të partisë time, ku lirimin e përkrahim në mënyrë unike, tani jam dakort që të përkrahem bizneset si tërësi, përfshirë këtu edhe bizneset e mëdha, që kanë qëndrueshmëri në tregun e lirë të operimit ekonomik, por edhe faktin tjetër që punën e tyre e bëjnë me respekt, nuk duhet të thuhet fjalë të këqija për asnjë operatorë ekonomik.

Shpend Bardiqi: Lidhur me propozimin për bizneset dhe lirimin e tyre nga taksat komunale, informacioni është i mangët, ky lirim bëhet sepse ne i kemi për bartje shumën e mjeteve financiare prej: 6.3 milion euro, këtu duhet ta kemi parasysh edhe kushtin social të operimit të disa bizneseve të vogla, të cilat e kanë vështirë të mbijetojnë në treg, kjo nuk është e njëjtë për bizneset në fushën e ndërtimit dhe bizneseve që ofrojnë shërbime dhe kanë mbi dhjetë punëtorë, këtu trajtimi nuk duhet të jetë i njëjtë. Po ashtu ne kërkojmë sqarime lidhur me konfliktin e interesit nga Zyrtari Ligjor i Kuvendit të Komunës.

Vlonjat Hasani: Kuvendi i Komunës ka punuar për hartimin e 'Rregullores së re për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale', ku janë klasifikuar edhe bizneset, por edhe taksat tjera komunale për fusha tjera, ku klasifikim është bërë nga Grupi Punues Komunal, këtu duhet të flasim me terma për secilën fushë, a përputhen nenet e kësaj rregullore me qëllimin e Ekzekutivit për lirimin e bizneseve nga taksat komunale, këtu me bizneset e komunës po bëhet politikë, këtu pyetja është pse Ekzekutivi i Komunës, e ka bllokuar ecjen tutje të rregullores në fjalë, që e rregullon edhe fushën e bizneseve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani unë do ta lexoi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku e trajton çështjen e konfliktit të interesit, e cila është e definuar në nenin 38, të këtij ligji.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Këtu qëllimi i propozimit është lirimi i bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, këtu nuk ka asnjë shkelje, sepse këtë punë e definon edhe Statuti i Komunës, ju po e bëni edhe interpretimin e formës, ne jemi duke funksionuar me rregulloren e vitit 2013, tani e kemi kërkesën për lirimin nga taksa komunale për 2750 biznese, një sallon ondullimi dhe një market i madh ndoshta pagujnë shumë prej: 500.00€, por kjo nuk vlenë për mikro bizneset dhe bizneset e vogla, që e kanë shumë vështirë të mbijetojnë. Uzurpimi i hapësirave publike, që u cëkë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Habib Mekolli, unë dua të ju sqaroi se ekonomia e lirë e tregut, funksionon sipas rregullave që nxirren nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe rregullativa ekonomike, ne jemi ekonomi e lirë e tregut, zhvillimi i sektorit privat është në interesin e komunës tonë, sepse krijohen vende të reja të punës për qytetarët dhe ruhen vendet ekzistuese të punës, këtu te ne punojnë punëtorë nga e gjithë vendi.

Laureat Gojnovci: Në parim në komunën tonë është një ambient i mirë për zhvillimin e bizneseve, ne kërkojmë që ta kemi një pauzë prej dhjetë minutave për sqarime.

Shpend Bardiqi: Ne jemi kundër marrjes së pauzës, sepse këtu çështja është shumë e qartë, nuk ka nevojë për ndërprerje të mbledhjes, as për konsultim shtesë.

Mirsad Qyqalla: Këtu ka dilema, a kemi apo nuk kemi të drejtë të votojmë, ndonjëri prej neve që ka biznes si pronarë, apo biznes familjarë, andaj jam kundër konsultimit për këtë punë, sepse ligji e thotë qartë këtë punë.

Hasan Ismajli: Edhe unë jam kundër marrjes së pauzës prej pesë minutave, e cila mund të zgjatë edhe më shumë, me sqarime tjera.

Etnik Berjani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam biznesin tim jashtë komunës tonë, andaj dua ta kem një konsultim shtesë, se a paraqet ky fakt shkelje të ligjit apo jo.

Pas sqarimeve u mor një pauzë në kohëzgjatje prej pesë minutave, me votim të gjashtëmbëdhjetë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Koha e pushimit prej pesë minutave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani debati për këtë çështje është shterrur, andaj e qesim në votim 'Propozimin për lirimin e bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, për vitin 2023, 2024 dhe 2025'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lirimin e bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e

veprimtarisë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, për vitin 2023, 2024 dhe 2025' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 420, të datës 20.02.2024, për vazhdimin e lirimit të bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitet 2023, 2024 dhe 2025, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Lirimi i subjekteve afariste nga taksa komunale e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike nga viti 2017-2022, me vendimet e Kuvendit të Komunës dhe vazhdimin e lirimit për periudhën e ardhshme të evidentuar në pikën një të vendimit, synon ruajtjen e vendeve të punës dhe rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik lokal nga Sektori privat në fushën e veprimtarive të tregtisë, shërbimeve, ndërtimtarisë, prodhimit, akomodimit dhe mikro - bizneseve, ku përfitues tani janë gjithsej 2750 biznese, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Pika e pestë (5) - Rishqyrtimi i shkresës Nr. 0-360/1, të datës 13.02.2024 për Rregulloren e Transparencës Nr. 228, të datës 29.12.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim tani 'Kërkesën për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës', sepse në muajin dhjetor 2023, ka dalur Udhëzimi Administrativ për Komuna të Hapura, unë nga diskutimi në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk jam për shfuqizimin e saj, por që Grupi Punues Komunal ta bënë harmonizimin e saj me udhëzimin e ri. Hap diskutimin.

Mirsad Qyqalla: Këtu dilema është se Udhëzimi Administrativ për Komuna të Hapura, ka shumë ndryshime dhe rregullorja nëse ndryshohet mbi 70%, duhet të hartohet si rregullore e re, e jo të bëhen ndryshim-plotësimi i saj, unë jam dakort që kjo rregullore të kthehet te Grupi Punues.

Vlonjat Hasani: Ne i kemi arsyetuar me kujdes shumë nenet e rregullores gjatë punës së Grupit Punues, ku unë kam qenë anëtarë, por në ndërkohë ka dalur Udhëzimi i ri Administrativ për Komuna të Hapura, këtu rekomandimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk është që të shfuqizohet, por të rishqyrtohet, që i bjen se ne duhet ta harmonizojmë rregulloren tonë me këtë udhëzim administrativ. Ne jemi që Grupi Punues të bënë rishqyrtimin e neneve të kësaj rregullore, por edhe të hartoi nene të reja sipas këtij akti të ri të Ministrisë për komuna të hapura, që nënkupton ndryshimin në shumë nene.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e qesim në votim 'Kërkesën për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës', me ndryshim-plotësimin e saj nga ana e Grupit Punues në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Komuna të Hapura'. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej me njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Kërkesën për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës', me ndryshim-plotësimin e saj nga ana e Grupit Punues në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Komuna të Hapura' dhe mori:

V E N D I M

1. Për rishqyrtimin e Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 0-36/1, të datës 13.02.2024, lidhur me ligjshmërinë e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 228, të datës 29.12.2023, me aprovimin e kërkesës për ndryshim-plotësimin dhe harmonizim e kësaj rregullore me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna.
2. Kuvendi i Komunës e autorizon Grupin Punues të formuar me vendimin Nr. 17, të datës 04.02.2022 nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës për përgatitjen e ndryshim - plotësimit të Rregullores për Transparencë.

Pika e gjashtë (6) - Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me kalendarin vjetor të organizimeve dhe aktiviteteve në kulturë dhe sport për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mbështetur në 'Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', është e paraparë kjo informatë nga ana e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Hap diskutimin.

Vlonjat Hasani: Ne e falënderojmë Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për përgatitjen e kësaj informate sipas planit vjetor të punës, por nuk pajtohemi me pa përgjegjësinë e tij ndaj Kuvendit të Komunës. Kjo informatë ka mangësi, andaj ku Ekzekutiv i Komunës bjen keqë, ai vetë në mbledhjen e kaluar, na ka thënë se do të na jap përgjigje me shkrim dhe ne ato përgjigje nuk i kemi sot.

Mirsad Qyqalla: Kjo informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, e ka një përmbajtjen e saj, ku parashihen disa aktivitete, por këtu drejtori nuk është prezentë, për deri sa ai nuk e respekton Kuvendin e Komunës, ne nuk lëshohemi në shqyrtimin e përmbajtjes së saj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani erdhi Drejtori i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, i cili tani do të na jap sqarime për këtë informatë.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam ardhur me vonesë, dua të ju sqaroi se tani unë jam në një regjim të caktuar nga mjeku dhe jam me terapi shëndetësore, andaj nuk kam qenë tërë kohën këtu, unë në informatë i kam paraqitur aktivitetet tona sipas planit vjetor të punës, i kam bërë ato publike përmes juve, me informatë për Kuvendin e Komunës dhe shpresoi se këto do t'i realizojmë së bashku me një partneritet edhe me juve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Informatën e kemi të shkruar, me aktivitete e parapara për realizim gjatë vitit 2024, unë kërkoi nga ju të gjithë që ta mirëkuptojmë Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Pika e shtatë (7) - Propozim për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës', ftoi Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të na jap sqarime.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi falje që ky projekt-statut, ka ardhur tek ju me vonesë, statuti është hartuar në bazë të Ligjit për Shëndetësi dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020, për rregullimin e kujdesit parësorë shëndetësorë, ku data e fundit për miratimin e tij është data 31 mars 2024, do ta kemi edhe

procedurën e diskutimit publik, ku projekt-statut është përgatitur nga Këshilli Drejtues i shëndetësisë në Qendrën tonë shëndetësore, andaj ju ftoi ta aprovoni në parim për diskutim publik, ku mund ta plotësojmë në ndonjë nen të caktuar, pas analizimit të kompetencave tona në kujdesin parësorë shëndetësorë sipas ligjit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Një statut për shëndetësinë primare, ne e kemi miratuar edhe në vitin 2017, tani është vetëm në leximin e parë, ta aprovojmë tani në parim për procedurën e diskutimit publik, pastaj i japim qëndrimet tona për nene të caktuara.

Mirsad Qyqalla: Ne këtu nuk e kemi një statut unik, ka dallime procedurale, sepse ne i kemi disa specifika si komunë, por ne duhet ta shqyrtojmë në mënyrë më të detajzuar, ta jap propozimet tona.

Hasan Ismajli: Nuk dua të përsëritem, por komuna jonë i ka disa specifika, a parashihet tani ta kem edhe radiologun, ndërsa sikur po shihet nuk do ta kemi tani pediatrin dhe gjinekologun.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Banorët e komunës tonë kanë nevojë për shërbime shëndetësore të pediatrit dhe gjinekologut.

Aida Alimi: Unë e kam dhënë me kohë propozimin për blerjen e Mamografit, kur tani e kemi radiologun, andaj tani kemi mundësi ta blejmë mamografin për të ndihmuar pacientët tonë, në fazat e hershme të identifikimit të sëmundjeve të rënda.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Prej 589 kërkesave të grave, vetëm një paciente ka dalur me diagnozë me sëmundje të rëndë, në fazën e hershme të saj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e qesim në votim 'Propozimin për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej me njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë' dhe procedimin e tij për diskutim publik.

Pika e tetë (8) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', të gjithë do ta keni kohën e duhur për parashtrimin e pyetjeve dhe marrjen e përgjigjeve.

Arbnora Kelmendi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, meqë drejtorat nuk janë prezentë në mbledhje, kërkoj që të mbeten në procesverbal pyetjet të cilat do t'i parashtroj. Kam dy pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, edhe pse drejtori besoj se është në dijeni, se në shkollën në Lismiri është e përfshirë prej minjëve afër dy muajve atje ka shumë minjë, të cilët shëtisin nëpër klasë, prindërit kanë bërë ankesë edhe në Drejtorin e Arsimit dhe ende kanë ndërmarrë asgjë në lidhje me këtë shqetësim. Pyetja tjetër është vendimin të cilin e ka marrë Drejtorja e Arsimit për mbylljen e derës së shkollës 'Selman Riza', fëmijët janë të rrezikuar, për arsye se transporti i cili po i sjellë fëmijët në shkollë, është i detyruar që t'i pres jashtë oborrit të shkollës dhe kur fëmijët po e përfundojnë procesin mësimor, po duhet me dal jashtë dhe me kërkur, se ku është duke i pritur transporti dhe me këtë ju u'a keni vështirësuar dhe e rrezikuar jetën fëmijëve.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, ku kanë marrë një vendim për mbylljen e dyerve nëpër shkolla dhe pyes drejtorin se aje duke dal në teren, sepse nëpër shkolla ka hapësira ku fëmijët mundën me dalë dhe njëherë duhet me rregulluar hapësirën, pastaj me marrë vendim për mbylljen e derës. Pyetjen tjetër prapë e kam për Drejtorin e Arsimit, pse nuk po e kanë guximin me kthyer përgjigje në e-mailin zyrtar te cilën e kam parashtruar para një muaji për bursat e studentëve serbë. Kam edhe një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, i cili nuk është prezentë, rruga prej objektit të Vivës e deri tek Pishat e Sllatinës së Vogël nuk mundën me u kaluar prej dy makinave, pyetja ime është pse nuk e keni zgjeruar rrugën? A ka inspektim që mirret pikërisht me këtë çështje? Buxheti po tepron dhe nuk jeni në gjendje një rrugë ta përfundoni ashtu siç duhet. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, tarasat e kanë mbuluar qytetin tonë, parkingjet te cilat janë pronë publike duhet të lirohen e sidomos tek shkollat, sepse keni marrë vendim mi mbyll dyert e shkollave dhe nuk lejojnë që fëmijët të dalin, andaj prindërit po janë të detyruar që të rrinë në rrugë t'i presin fëmijët e tyre për shkak se parkingjet janë të zëna.

Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë pyetjen e parë e kam për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, a keni paraparë ndryshim në subvencionimin e fermerëve dhe të Komunës së Fushë-Kosovës, apo do të jetë e njëjta, siç ka qenë më herët, duke i pasur parasysh se komunat tjera, si shembull Komuna e Lipjanit i kanë subvencionuar në litër qumështi fermerët. Kush ka qenë në mandatin e kaluar e dinë sepse unë dhe kolegu im z. Durim Hajra, e kemi përmend disa herë kompaninë 'Kosmonte Foods', një uzupatorë i cili e ka marrë së fundi statusin investitor strategjik nga Qeveria, i cili ka bërë shumë shkelje në atë pjesë, duke filluar nga një pronë prej afër 4 hektar dhe këtë pronë e ka si me pasë të vetën dhe në vitet e më hershme, ja ka marrë Drejtoria e Pylltarisë dhe ka qenë kontest gjyqësorë me Drejtorinë e Pylltarisë. Pronari i kompanisë 'Kosmonte Foods', ka bërë kërkesën në mandatin e kaluar në këtë Kuvend, me ndërruar me një pronë me Blinajë, një pronë ku ari kushton dy - tre qind euro, ndërsa ku ka qenë kushton dhjetë mijë euro ajo pronë. Komuna e Fushë Kosovës e ka lejuar me ndërruar dhe i ka dhënë leje me ndërruar, ndërsa në atë pronë ku ka qenë lejohet vetëm ndërtim i vrazhdë, ndërsa ky person ka filluar punimet edhe pse është në kontest gjyqësorë me Drejtorinë e Pylltarisë, ka filluar me kanalizim, pyetja ime është, a ka bërë kërkesë në Komunën e Fushë-Kosovës për leje ndërtimi, inspektoriat i mbikëqyrë këtë kompani?

Hasan Ismaili: Para disa dite kam bërë një kërkesë për qasjen në dokumente zyrtare për studentët serbë, të cilët kanë aplikuar për bursë studentore në Drejtorinë e Arsimit, ku drejtoria i subvencionon me vite të tëra studentët tanë në Komunën e Fushë-Kosovës. Serbët të cilët kanë aplikuar dhe kanë marrë bursë, ku për 2023 kam informatë se është ndaluar dhe presin interpretim ligjor nga Zyra Ligjore. Drejtoria e Arsimit vitet e më hershme i ka subvencionuar këta studentë të cilët studijojnë në Fakultetin e Mitrovicës së Veriut dhe në dokumentat e tyre shkruan Republika e Serbisë - Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, Mitrovica e Kosovës Universiteti Prishtinë dhe vula është me të njëjtin shkrim, vetëm se në mes i ka katër esat që na provokojnë dhe njëjtë shkruan në indeks dhe certifikatë të notave, të cilën e ka dëshmuar se ka notën mesatare mbi 7, ku ka qenë edhe kushti dhe vërtetimi që është studentë, ku në të gjitha këto dokumente shkruan Republika e Serbisë, vendbanimi Fushë-Kosovë. Duhet të jepet llogari për ata të cilët i kanë subvencionuar me këto dokumente dhe me këtë vullë, ne nuk duhet me lejuar me shkel mbi gjakun e të vrarëve dhe për një votë me bë këto shkelje nuk është në rregull, kjo duhet mu hetuar, sepse këto dokumenta që i kam janë zyrtare dhe i kam marrë nga ju. Kërkoj nga drejtoritë që ta kemi një pasqyre për të gjithë përfituesit e subvencioneve. Pyetjen tjetër e kam sa drejtor komunal janë me aktakuzë, sa janë nën hetime, sa zyrtarë në Kuvendin Komunal janë duke u hetuar, kishte qenë

mirë me qenë edhe Nënkryetari i Komunës i pranishëm, këtu ka hyr edhe prokuroria speciale dhe është mirë me u ndaluar këto pa rregullësi.

Krenar Dumani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, së pari ia uroj pozitën Drejtoreshës së Bujqësisë dhe besoj se është profesioniste e fushës dhe ka me dhënë kontributin e vetë. Desha ta ngriti një çështje tek Ekzekutivi i Komunës dhe tek drejtoritë përkatëse për Xhaminë e fshatit Miradi e Poshtme, e kemi marrë një hapë fshati dhe i kemi pastruar hapësirën e Xhamisë së vjetër, ku besoj se është e dyta për nga vjetërsia më shumë se një qind vjet, që na ka shërbyer si fshat dhe kjo rrezikohet çdo ditë me u shembë, tani i nderuari Kryesues i Kuvendit t'i kam dërguar edhe disa fotografi dhe kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës, me ndërmarrë një hapë dhe kisha kërkuar së bashku që të ruhet si monument historik kjo Xhami, sepse vetëm Xhamia e fshatit Harilaç është më e vjetër se kjo.

Shpend Bardiqi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë pata disa pyetje, mirëpo me pyetjen që e parashtroui kolegu im z. Hasan Ismajli, me rastin e subvencionimi të studenteve me dokumente të Serbisë, besoj që s'kemi çka me diskutuar më. Mendoj se kjo duhet me u hetuar, unë dhe subjekti im do te ndihmojmë me aq sa kemi mundësi, me i shkuar deri në fund kësaj pune, sepse s'ka kuptim më dhe në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, po flas që nuk ja vlen me bë pyetje, të paktën sot më, sepse nuk e di a ja vlen me ardhur më me një Kuvend Komunal me diskutuar, sepse Kryetari i Komunës dhe unë si asambleistë i Komunës së Fushë-Kosovës nuk qen kemi të së njëjtit në këtë qytet. Kjo është për me qajhtë të nderuar kolegë. Kjo pyetje që e parashtrouj kolegu z. Hasan Ismajli është pyetja më e rëndësishme që ka pas deri tash.

Aida Alimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është skandaloze çështja që u diskutua nga kolegu z. Hasan Ismajli. Dua ta di pse nuk është prezentë Kryetari i Komunës dhe Nënkryetari i Komunës, sepse me ligj duhet me qenë prezentë, të paktën nëse Drejtorati nuk na përgjigjen ata me marrë këtë rol dhe me na u përgjigje neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Drejtori për Arsimit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pyetja e parë nga Dardana për vendimin e mbylljes së shkollave, është marrë në kordinim të plotë me Stacionin Policorë të Komunës së Fushë-Kosovës, pas takimit që kemi pasur me ta është rekomanduar nga ana e tyre, për shkak të sigurisë së nxënësve në komunikacion që të vlerësohet, mundësia e mbylljes së portës së shkollës, qysh edhe kemi vepruar dhe ende nuk jemi në zbatim një qind për qind të këtij vendimi, me të vetmen arsye se ne disa hapësira të rrethojave ka qenë e hapur dhe jemi duke i eliminuar me te vetmen arsye pa mundësimin e daljes së fëmijëve në rrugë, ku sipas Stacionit Policor rrezikshmëria është shumë e lartë, komunikimi me Drejtorin e Inspektoriatit me vendimin e hapësirave afër shkollave, janë hapësira publike dhe mund të përdoren nga kush do që ka nevojë dhe kjo është arsyeja e vetme se afër shkollave nuk i kemi larguar të gjitha makinat, duke pasur parasysh mungesën e madhe të parkingjeve në Komunën e Fushë-Kosovës, kjo është njëra ndër arsyet që s'kemi mundur me vepruar. Sa i përket pyetjes së z. Hasan Ismajli, katërmëdhjetë studentë, banorë të Komunës së Fushë-Kosovës, me letërnjoftim të Republikës së Kosovës, banorë të Kuzminit, kanë aplikuar në vitin 2023 për bursa studentore dhe këta janë banorë të Kuzminit dhe komisioni, i cili i ka shqyrtuar dosjet, në kriteret të cilat kanë qenë të shpallura, ka qenë letërnjoftimi me adresë të Komunës së Fushë-Kosovës, që në këtë rast nuk kanë bërë asnjë shkelje, ndërsa sa i përket hapave tjerë të dokumentacionit brenda dosjes së tyre, pasi që është analizuar unë kam nxjerrë vendim për mos ekzekutimin e atyre bursave, unë foli vetëm për vitin 2023 që kam qen unë, nuk flas për më herët, sepse nuk jam i informuar. Unë ta dokumentoj me vendim që këta katërmëdhjetë student nuk kanë marrë bursa për shkak të dokumentacioneve që i kanë pasur. Kolegu z. Hasan Ismajli e përmendi listën e përfituesve kjo listë është në faqe të Drejtorisë

Komunale të Arsimit dhe e kanë publikuar unë. Sa i përket vendimit për normat që janë kthyer, unë sapo i dërgova shkresë Minsitrisë së Arsimit për sqarim se si të veprojmë.

Dardane Sogojeva Shala: A keni marrë ndonjë vendim për pjesën e drogave që po merret nëpër shkolla, e posaqërishtë në shkollën 'Mihal Grameno', a keni ndonjë bashkëpunim edhe me Policinë me pas kontroll vazhdimisht aty.

Drejtori i Arsimit: Droga po merret në shkolla nuk qëndron, në shkollën 'Mihal Grameno' në shkallët emergjente janë kapur nga Policia e Kosovës disa persona të cilët nuk janë pjesë e shkollës, por kanë hyrë në oborrin e shkollës, që nuk janë nxënës dhe mendimi im për mbylljen e portave ka me na ndihmuar për parandalimin e këtyre dukurive negative. Vitin e kaluar kur kam ardhur si Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, nuk ka pasur fare kontratë të nënshkruar për dezinfektim tash jemi në përfundim me lidh një marrëveshje me Drejtorinë e Bujqësisë. Në Lismir s'ka bazë fare shkolla dhe për këtë arsye është në këtë gjendje. Vendimi për mbylljen e portave është marrë dhe nuk kemi mundësi me ju rezervuar parkingje të veçanta, unë kam kërkuar nga policia që mos t'i pengojnë transportuesit në minutazh, tre minuta deri sa t'i dërgojnë dhe t'i marrin fëmijët. Transportuesi nuk guxon me hy brenda oborrit të shkollës, sipas ekspertit dhe nuk dua ta marrë përgjegjësi.

Mirsad Qyqalla: Deshta të pyes për një vlerësim i cili është në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, si ka mundësi vlerësimi i procesit të bëhet prej kolegëve kurse niveli është i barabartë, çfarë standardi keni përdorë që i keni përcaktuar këta persona si vlerësues dhe cili është përfitimi i tyre.

Drejtori i Arsimit: Dje kam qenë në takim me shkollën e Gjinnazit me klasët e teta dhe të nënta të shkollës 'Mihal Grameno', janë rreth njëzet mesimëdhënës, të cilët nuk e kanë pranuar vetëvlerësimin, nuk kemi të bëjmë me vetëvlerësim profesional, por me vetëvlerësim të procesit nga kolegu për kolegun, ku nuk ka rëndësi fare se sa vite është në marrëdhënie pune, sepse janë pesë fusha dhe në fund të ditës na detyrojnë, që për planin e punës së vitit të ardhshëm do të përfshihen edhe persona të tjerë.


Drejtoresha për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Përshëndetje për të gjithë, unë me datë 22.02.2024 jam emëruar si Drejtoreshë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nga Kryetari i Komunës. Unë me profesion jam agro-ekonomiste, fermerët në të kaluarën janë subvencionuar me participim 3% dhe ne mendojmë, që këtë ta heqim krejt si participim, për arsye se buxhetin e kemi të kufizuar dhe këtë vitë do ta bëjmë shpalljen për serra, moto-kultivator dhe mekanizëm bujqësorë, në punën time unë do të mundohem që të jem sa më transparente dhe po ashtu do t'i subvencionojmë edhe fermerët për litër qumështi, varësisht prej mundësive buxhetore.

Mirsad Qyqalla: Unë ju uroj për pozitën e re dhe shpresojmë se do të jeni transparente, duke i publikuar listat e përfituesve në bujqësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtoresha e re tani është duke bërë skanimin e gjendjes, por unë i sugjeroj që të bashkëpunon edhe me Komitetin për Bujqësi, Mjedis dhe Ujëra, ku anëtar i Kuvendit z. Krenar Dumani është ekspert i fushës, por edhe ne si Kuvend do të jemi në përkrahje të fushës së bujqësisë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:35 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

